

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5838  
E shtunë, 27 korrik 2019  
çmimi 0.40 €

## Meta i shkruan OSBE-së për krizën politike në Shqipëri



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
www.awr-abbruch.de

### AKTUALE

**MAQEDONIA E VERIUT MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR GJUHËN SHOIPE, PARASHIKOHEN EDHE GJOBA** F. 2

**VESELI TAKON PËRFAQËSUESIT E DEGËVE TË PDK-SË, MOBILIZOHET PËR ZGJEDHJE TË REJA** F. 5

**A PO KALON AGIM BAHTIRI NË AAK?** F. 6

### EKONOMI

**KOSOVA PËRFITON MBI 6 MILIONË EURO GRANTE NGA WBIF** F. 9

**VETËVENDOSJA KËRKON NGA BORDI I TELEKOMIT MOS T'IA VAZHDOJË KONTRATËN 'Z-MOBILE'-S** F. 9

### KULTURË

**ZOTI E BEKOFTE 'AMERIKËN!': TË GJITHË JEMI 'AMERIKANË', TË GJITHË JETOJMË NË 'AMERIKË'!** F. 9

AGRON SHALA



### SPORT

**GASHI: SPORTISTET KULMINANTE DO TA KENË PËRKRAHJEN E SHTETIT** F. 20

**WILLIAMS: NUK DUA TA BARAZOJ REKORDIN, POR TA THYEJ** F. 20

QEVERIA E KOSOVËS KA MBAJTUR MBLEDHJEN E PARË PAS DORËHEQJES SË KRYEMINISTRIT RAMUSH HARADINAJ, POR NUK KA MARRË ASNJË VENDIM

# Haradinaj i drejtohet Kushtetueses për t'i qartësuar kompetencat e qeverisë në dorëheqje



Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka vendosur t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për ta dhënë vlerësimin nëse qeveria në dorëheqje mund të marrë ndonjë vendim. Ky veprim i Haradinajt ka ardhur pasi në mbledhjen e qeverisë të premtën anëtarët e kabinetit kanë shfaqur hezitim për të marrë vendime lidhur me temat e caktuara. Madje ata kanë kërkuar qartësi juridike nga kryeministri edhe rreth vendimit për t'i siguruar KQZ-së mjete financiare për mbajtjen eventuale të zgjedhjeve të parakohshme. Mirëpo juristët veprimin e Haradinajt për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese e kanë vlerësuar të panevojshëm, pasi mund ta vonojë edhe zgjedhjen e qeverisë së re

## Vihet gurthemeli për ndërtimin e shtatores së Adem Demaçit

Përfaqësues të institucioneve të vendit, kryetarë partish, veprimtarë të çështjes kombëtare, ish të burgosur politikë, qytetarë dhe familjarë, të premtën kanë bërë homazhe pranë varrit të veprimtarit dhe simbolit të rezistencës së çështjes

kombëtare, Adem Demaçi, me rastin e njëvjetorit të ndarjes nga jeta. Po në këtë përvjetor është vënë edhe gurthemeli për ndërtimin e shtatores së Demaçit te parku që mban emrin e tij të "Rrethi i Flamurit" në Prishtinë



**Hahni i tregon Serbisë se e ardhmja evropiane e saj është e ndërlydhur me dialogun me Kosovën** FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Kadetët e FSK-së përfunduan me sukses ushtrimin ndërkombëtar "Kampi Veror 2019"

SHKUP, 26 KORRIK (ER) - Me stërvitjen taktike në poligonin ushtarak në Krivollak të Maqedonisë së Veriut, kadetët e akademive ushtarake të 12 shteteve pjesëmarrës përfunduan me sukses ushtrimin fushor "Kampi Veror 2019". Në këtë ushtrim, krahas kadetëve të ShBA-së,

Shqipërisë, Gjermanisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës Çeke, Bullgarisë, Kroacisë, Malit të Zi, Norvegjisë, Maqedonisë së Veriut morën pjesë edhe kadetët e FSK-së, të cilët demonstruan me sukses aftësitë e tyre profesionale si dhe nivelin e gatishmërisë të

fituara gjatë studimeve në QSU. Ditën kryesore të ushtrimit fushor "Kampi Veror 2019" ushtrimin e përcolli nga afër gjeneralbrigade Irfete Spahiu, komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, si dhe oficerë të lartë të Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së.



## Meta i shkruan OSBE-së për krizën politike në Shqipëri

TIRANË, 26 KORRIK - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka bërë me dije të premtën se u është drejtuar me një letër përfaqësuesve të OSBE-së nga të cilët ka kërkuar që të vijnë në Tiranë për ta negociuar krizën politike në të cilën gjendet shteti shqiptar. "Sot unë kam formalizuar dhe një letër drejtuar sekretarit të përgjithshëm të OSBE-së, por edhe kryetarit të radhës së OSBE-së, ministrit të Jashtëm të Sllovakisë dhe presidentit të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, meqenëse Shqipëria përgatitet për ta marrë kryesimin e OSBE-së vitin e ardhshëm dhe ky është një moment i rëndësishëm dhe historik për të negociuar me të dyja palët këtu për arritjen e një zgjidhjeje sa më të shpejtë, pasi nuk kemi kohë. Jo vetëm për ta parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të kësaj situate të padenjë për qytetarët, por edhe për një vend i cili duhet të jetë

shembull në kryesimin e OSBE-së", ka thënë Meta.

Për krizën politike për herë të parë presidenti Meta ka bërë përgjegjëse edhe opozitën shqiptare. "Kam insistuar prej shumë kohësh për dialog dhe jo për diversion dhe demagogji, por për marrje përgjegjësisë nga të gjitha palët për ta rivendosur normalitetin dhe demokracinë në vend dhe që të funksionojë llogaridhënia. Sot kemi një parlament që nuk jep llogari para askujt, një shumicë që kontrollon gjithçka, një situatë kaotike në të gjitha drejtimet. Kjo është përgjegjësi e të gjitha palëve, asnjë nuk mund të shfajësohet, sepse opozita i ka pasur mundësitë për të parandaluar me propozime me këmbë në tokë dhe të përgjegjshme shumë nga këto marrëzitet e skenarit të kapjes së institucioneve. Shqipëria nuk mund të ecë në dy rrugë që nuk takohen me njëra-tjetrën që



janë: rruga e kapjes së institucioneve nga njëra anë dhe rruga tjetër e delegjitimitimit të të gjitha institucioneve. Ne jemi

një vend dhe kemi nevojë për një rrugë të përbashkët, anëtarësimi në BE dhe dy palët të tregojnë përgjegjësi për të mos e cenuar këtë vullnet", është shprehur Meta. Sipas Metës, kostoja e krizës politike do të duket në tetor në vendimin e hapjes së negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE). "Ajo që na shqetëson më shumë është ky teatër absurd politik, i cili kërcënon që Shqipëria ta dërrmojë çdo mundësi për t'i çelur negociatat në tetor, prandaj u bëj thirrje të gjithëve, e sidomos të tre artistëve, t'i japin fund këtij absurdi, t'i marrin masat për zbatimet vendore për 13 tetorin sepse qytetarët shqiptarë kanë nevojë të kenë qetësi dhe normalitet, një qeverisje vendore të ligjshme e që garanton llogaridhënie", ka thënë ai, duke shtuar se zgjedhjet e 13 tetorit nuk do të zgjidhin gjithçka.

## Maqedonia e Veriut miraton projektligjin për gjuhën shqipe, parashikohen edhe gjoba



SHKUP, 26 KORRIK - Qeveria e Maqedonisë së Veriut ka miratuar në mbledhjen e fundit projektligjin për themelimin e inspektoratit për zbatimin e gjuhëve, konkretisht asaj shqipe. Ligji i ri parashikon ta rregullojë mënyrën e inspektim-

it, përzgjedhjen e inspektorëve dhe penalitet (gjobat) në rastet kur nuk zbatohet përdorimi i gjuhës shqipe. Në penalitet parashikohen gjoba 300 deri në 500 euro për institucionet që nuk lejojnë inspektimin e materialeve. Po ashtu, parashikohen

gjoba nga 100 deri në 200 euro për drejtuesit e atyre institucioneve.

Inspektoratin do ta udhëheqë drejtori i cili zgjidhet përmes një konkursi publik për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhje.

## MASHT-i dhe Banka Botërore, të kënaqur me zbatueshmërinë e projektit KESIP

Prishtinë, 26 korrik (ER) - Përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Baton Dushi nga kabineti i ministrit dhe Alush Istogu nga Departamenti për Arsim Parauniversitar, kanë zhvilluar të premtën një takim me përfaqësues të Bankës Botërore, Angela Demas, Blerim Saqipi dhe

Mrika Aliu, ku është diskutuar për ecurinë e projektit KESIP. Në këtë takim përfaqësuesit e Bankës Botërore u shprehën të lumtur lidhur me ecurinë e projektit, ku u tha se, krahasuar me muajt e mëhershëm, që kishte vështirësi të theksuara në zbatueshmërinë e projektit, kohët e fundit kemi një qasje ndryshe të

Ministrisë në funksion të përbushjes së objektivave të planifikuar. Shefi i kabinetit, Dushi, njëherësh ushtrues i detyrës së koordinimit të projektit, në emër të ministrit Bytyqi ka thënë se janë të kënaqur që kanë kaluar disa pengesa që kishin më herët dhe kjo është arritur falë angazhimit të përbashkët.





# Hahni i tregon Serbisë se e ardhmja evropiane e saj është e ndërlydhur me dialogun me Kosovën

PRISHTINË, 26 KORRIK - Dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit dhe rezultati i tij është "bërthamë e përparimit" të rajonit në rrugën e integritit evropian, ka thënë të në Beograd komisionari për zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn. Duke folur në një konferencë të përbashkët për gazetarë me kryeministren e Serbisë, Ana Bërnabiq, Hahn ka thënë se e ardhmja evropiane e Serbisë qëndron në normalizimin e marrëdhënieve me Prishtinën dhe se ky normalizim do të vazhdojë të mbështetet nga BE-ja.

Hahn ka pohuar se në vitin 2018 ka pasur përparime të rëndësishëm, por që nuk mund të bëhej edhe më shumë. Ai ka lavdëruar hapjen e kapitujve të rinj të negociatave për anëtarësimin e Serbisë në BE, por ka theksuar se Serbia ka ende sfida përpara. "Në pranverë të vitit 2020 do të duhet të mbahen zgjedhjet. Jeni të thirrur t'i respektoni rekomandimet", ka

pohuar Hahn.

Kryeministrja e Serbisë, Ana Bërnabiq, ka thënë se vendi i saj mbetet sinqerisht i përkushtuar për rrugën evropiane. "E kuptojmë se në ç'moment është BE-ja dhe sfidat me të cilat përballet, por e kuptojmë edhe atë që duhet të bëjmë ne për t'u bërë Serbi evropiane. Nuk bëjmë reforma sa për t'i përmbushur kushtet, por punojmë sinqerisht në to", ka deklaruar ajo.

Bërnabiq ka thënë se Serbia po punon për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian. Hahn arriti në Beograd të enjten në mbrëmje, kur edhe u takua me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Ata biseduan për situatën në Ballkanin Perëndimor dhe për "hapat e ardhshëm të Serbisë në rrugën evropiane", u tha në një njoftim të Presidencës së Serbisë. Sipas të njëjtit, Vuçiq dhe Hahn shqyrtuan në mënyrë të veçantë ngecjen në dialogun ndërmjet Prishtinës



dhe Beogradit dhe situatën pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit të Kosovës, ndaj së cilës, siç tha Vuçiq, Serbia "reagoi me qetësi dhe përgjegjësi".

Vuçiqi e falënderoi Hahnin për angazhimin për "zhblokimin e dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës" dhe tha se "Serbia është e përkushtuar ndaj poli-

tikave të paqes dhe bashkëpunimit për ta ruajtur stabilitetin në rajon".

Hahn e mirëpriti "vendosmërinë e Serbisë" dhe shprehu gatishmërinë e tij për "të ndihmuar në krijimin e kushteve për vazhdimin e dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës".

Dy palët kanë ndërprerë dialogun për normalizim marrëd-

hëniesh qysh në fund të vitit të kaluar, kur Kosova u ka vënë taksë 100 për qind prodhimeve të importuara nga Serbia. Pavarësisht prej thirrjeve të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian për heqjen e taksës, Kosova vazhdon ta mbajë në fuqi atë.

Presidenti serb e ka kushtëzuar vazhdimin e dialogut me heqjen e taksës.

Johannes Hahn para vizitës në Serbi ka qëndruar edhe në Maqedoninë e Veriut, ku ka kërkuar nga qeveria në Shkup që të zbardhen të gjitha skandalet korruptive. "Të gjitha partitë politike duhet të tregojnë gatishmëri për bashkëpunim dhe të fokusohen që në tetor ta fitojnë datën për fillimin e negociatave për anëtarësimin e vendit në BE", ka theksuar Hahn, duke shtuar se të gjitha partitë politike duhet të jenë të hapura dhe të bashkëpunojnë që në tetor vendi ta marrë datën për hapjen e negociatave me BE-në.

## AAC-ja: Udhëtarët mund të kërkojnë kompensim nga 'ALK Airlines' për vonesat e shkaktuara

**EPOKA  
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 KORRIK - Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës (ACC) ka bërë me dije se më 24 korrik 2019 aeroplani i kompanisë ajrore "ALK Airlines" gjatë fazës së nisjes së fluturimit nga Shtutgarti për në Prishtinë ka pësuar një rrjedhje të lëngut hidraulik nga aktivizuesi i spoilerit të fluturimit në krahun e djathtë.

Sipas këtij autoriteti, ekuipazhi i fluturimit e ka ndërprerë nisjen dhe ka kthyer aeroplanin në platformë, duke i zbritur të gjithë udhëtarët nga aeroplani, ndërsa kompania ajrore është munduar ta riparojë defektin e shkaktuar. "Mekanikët e angazhuar nga kompania kanë rregulluar defektin dhe përfundimisht, aeroplani është nisur nga Shtutgarti rreth orës 18:40 dhe ka arritur në Prishtinë në orën 20:24, me një vonesë të përgjithshme prej 6 orësh e 24 minutash. Të nesërmen, më 25 korrik 2019, inspektorët e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës kanë kryer një inspektim SAFA (inspektim në platformë i mjetve ajrore të operatorëve të huaj) të aeroplanit 'LZ-MVK' të 'ALK Airlines', në Aeroportin



Ndërkombëtar të Prishtinës 'Adem Jashari', është thënë në njoftimin e ACC-së.

Gjatë këtij inspektimi inspektorët nuk kanë konstatuar ndonjë

gjetje që do të ndikonte në sigurinë e këtij mjeti ajror për fluturim.

"AAC është në dijeni për pakënaqësitë e udhëtarëve për situatën e krijuar lidhur me

vonesën e fluturimit 'VBB3208' të kësaj kompanie ajrore për të cilat shprehim keqardhje, por njëkohësisht i informojmë të gjithë udhëtarët se sipas legjislacionit

në fuqi mund të kërkojnë kompensim nga kompania ajrore për vonesën e shkaktuar", është thënë në njoftimin e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.



Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e parë pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj, por nuk ka marrë asnjë vendim

# Haradinaj i drejtohet Kushtetueses për t'i qartësuar kompetencat e qeverisë në dorëheqje

Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka vendosur t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për ta dhënë vlerësimin nëse qeveria në dorëheqje mund të marrë ndonjë vendim. Ky veprim i Haradinajt ka ardhur pasi në mbledhjen e qeverisë të premtën anëtarët e kabinetit kanë shfaqur hezitim për të marrë vendime lidhur me temat e caktuara. Madje ata kanë kërkuar qartësi juridike nga kryeministri edhe rreth vendimit për t'i siguruar KQZ-së mjete financiare për mbajtjen eventuale të zgjedhjeve të parakohshme. Mirëpo juristët veprimin e Haradinajt për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese e kanë vlerësuar të panevojshëm, pasi mund ta vonojë edhe zgjedhjen e qeverisë së re

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 KORRIK - Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhje të premtën, por nuk ka marrë asnjë vendim pasi, me të filluar mbledhja, zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj dhe ministri e tjerë të kabinetit kanë ngritur çështjen e kompetencave të kësaj qeverie për të nxjerrë vendime pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj. Për ta sqaruar këtë situatë, Haradinaj ka treguar se do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për ta sqaruar situatën.

Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka qenë i pari i cili ka kërkuar moskonsumimin e rendit të ditës në këtë mbledhje, duke thënë se në këtë situatë qeveria mund të dërgohet në Kushtetuese. "Ne kemi mbajtur edhe në të kaluarën mbledhje si qeveri në dorëheqje, por kjo nuk është e njëjtë me situatat në të kaluarën. Prandaj nuk mendoj se ne duhet të marrim ndonjë vendim tash dhe për ta çuar veten në

Gjykatë Kushtetuese. Nuk ma merr mendja se kjo na ndihmon", ka thënë Hoxhaj, duke kërkuar racionalitet politik. "Ajo çka na duhet është të kemi racionalitet politik dhe mos ta bllokojmë vendin. Unë nuk e përjashtoj mundësinë që ka institucione që kanë nevojë për mbështetje të Qeverisë së Kosovës, por kolegët ministra më nuk mund të sjellin pika të rendit të ditës për borde, ç'borde, pronësime dhe shpronësime sikurse ka ndodhur në të kaluarën, sepse më nuk ka prioritet qeverisë sikurse ka pasur deri më tash", ka thënë ai.

Ndërsa kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka kërkuar ndihmën e anëtarëve të kabinetit se si të veprohet më tutje. Ai ka thënë se e vetmja rrugë i mbetet që t'i drejtohet Kushtetueses me një pyetje, për t'i sqaruar kompetencat e qeverisë në dorëheqje. "Ju lus të më jepni një mendim, a dëshironi të vendosim bashkërisht për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, apo dëshironi për ta shqyrtuar bazën e zyrës

ligjore. Si ta vlerësoni bashkërisht, unë jam për. Prej ditës së stome kam frikë të thërras takim të qeverisë, sepse nuk e di më se cili vendim është i cilës kategori. Edhe nëse bëjmë marrëveshje politike me z. Limaj dhe Veseli, unë prapë nuk e di, sepse nuk kam marrëveshje me Gjykatën Kushtetuese. Do të jem i detyruar për të bërë qartësim ligjor nga institucioni përkatës, në këtë rast Gjykata Kushtetuese", ka thënë Haradinaj.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, e ka ngritur si diskutim çështjen e ndarjes së mjeteve për KQZ-në, të cilat do t'iu duhen për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme. "Viti 2019 nuk ka qenë vit i zgjedhjeve. Rrjedhimisht nuk kemi as buxhet të ndarë për KQZ-në, pra që të kemi mjete financiare të mjaftueshme për organizimin e zgjedhjeve, nëse vendosim të shkojmë në zgjedhje. Kemi për të ardhur në një situatë ku si qeveri kemi për obligim për t'iu ndarë mjetet financiare për KQZ-në", ka thënë



Tahiri.

Më pas kryeministri në dorëheqje ka ngritur edhe çështjen e vakuimit institucional, duke thënë se përgjegjësi është edhe mosveprimi. "Nëse ne nuk takohemi dhe nuk ndodhin disa punë përgjegjësi mund të bjerë mbi ne dhe mbi mua, sepse nuk kemi vepruar. Sepse, qysh e dini, edhe mosveprimi është përgjegjësi. Në këto rrethana unë jam i detyruar t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese. E di që më mirë kohë,

po me shpresë që të na kthejë përgjigjen më shpejt", ka treguar Haradinaj. Në debat është inkuadruar edhe ministri i Financave, Bedri Hamza, i cili ka treguar se ku mund të gjenden mjetet financiare për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme. "Kur jemi te çështja e mundësisë së shkuarjes së vendit në zgjedhje ne si Ministri i Financave kemi qenë të kujdesshëm në këtë drejtim dhe është një fond brenda ministrisë, ku ligji e autorizon ministrin që këto mjete, në rast nevojë, mund t'iu bartë në një organizatë tjetër buxhetore", ka thënë ai.

Hamza ka thënë se do të ishte i nevojshëm të ndodhë një takim mes liderëve të koalicionit në mënyrë që të diskutohet kjo çështje. Por kur është pyetur nga kryeministri në dorëheqje nëse ka të drejtë tani të marrë vendimin për ndarjen e këtyre mjeteve, ministri i Financave ka bërë me dije se i duhet qartësi juridike. "Për të ndodhur ky transferim fillimisht

duhet të ndodhë shpallja e zgjedhjeve. Së dyti, KQZ-ja duhet të bëjë një kërkesë të specifikuar për nevojat të cilat janë, për ta arsyetuar kërkesën e tyre. Mbi bazën e kërkesës së arsyetuar atëherë i hapet mundësi ministrit të Financave për ta bërë transferimin e mjeteve. Por në këtë rast edhe ministri i Financave kërkon qartësi juridike mbi statusin e tij", ka thënë Hamza, duke shtuar se këtë qartësim juridik nuk mund ta mbyllë zyra e tij ligjore. Sipas Hamzës, këtë qartësim mund ta bëjë vetëm Gjykata Kushtetuese.

Ndërsa zëvendëskryeministri Dardan Gashi ka treguar për efektet e një veprimi të tillë të qeverisë. "Pyetja drejtuar Gjykatës Kushtetuese i pezullon pastaj aktivitetet e qeverisë deri në një përgjigje nga ky institucion", ka treguar Gashi.

Në fund, edhe ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, ka kërkuar nga kryeministri që ta qartësojë kabinetin me këtë çështje. "Si kryetar qeverie e keni obligim të na qartësoni ne ministrave se çfarë duhet të bëjmë në këtë situatë, pra nëse kemi të drejtë të marrim vendime", ka thënë ministri në detyrë, Reçica.

Avokati i njohur Dastid Pallaska e ka kundërshtuar veprimin e Haradinajt për t'iu drejtuar Kushtetueses lidhur me kompetencat e qeverisë në dorëheqje. Ai ka bërë me dije se iniciativa e kryeministrit të dorëhequr për të dërguar pyetje në Gjykatën Kushtetuese për fushëveprimin e "mandatit" të qeverisë së re





është e panevojshme, e pavend dhe palejuar. "E panevojshme sepse kjo çështje nuk rregullohet me Kushtetutë dhe është fare e qartë se qeveria e dorëhequr nuk ka mandat qeverisës por, thjesht, shërben si

kujdestare e institucioneve vartëse deri në transferimin paqësor të pushtetit te qeveria e re. E pavend sepse mund të vonojë pa nevojë zgjedhjen e qeverisë së re apo proceset e tjera kushtetuese pasi që, sipas

praktikës së fundit, vendimi i Gjykatës Kushtetuese për 'pyetje kushtetuese' merret pas 6 apo 7 muajsh edhe në rastet kur kërkesa hedhet poshtë si e palejuar", ka shkruar Pallaska në profilin e vet në "Facebook".

Ai ka sqaruar edhe pse një kërkesë e tillë është e palejuar. "E palejuar sepse Gjykata Kushtetuese në tri vendimet e fundit në lidhje me 'pyetjet kushtetuese' të presidentit (Rastet KO Nr. 79/18, KO Nr.

Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, ka thënë se Haradinaj nuk po e kupton që më nuk është kryeministër dhe duhet të largohet nga kryeministria. "Sot tha se do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për ta pyetur se çfarë vendimesh ka të drejtë të marr. Ky nuk po e kupton ose nuk po do ta kuptojë që nuk është kryeministër dhe as nuk ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Le ta shohë nenin 113 të Kushtetutës i cili specifikon juridiksionin dhe palët e autorizuar pranë Gjykatës Kushtetuese. Zgjedhje të jashtëzakonshme sa më parë! Si erdhi, filloi me skandale dhe e përfundoj mandatin me skandale", ka shkruar Haxhiu në llogarinë e vet në "Facebook".

131/18 dhe KO Nr. 181/18) ka konstatuar, ndër të tjera, se Gjykata Kushtetuese nuk përgjigjet në "pyetje kushtetuese" dhe se kërkesat me pyetje të tilla do t'i hedhë poshtë si të palejuara", ka vlerësuar Pallaska.

## Veseli takon përfaqësuesit e degëve të PDK-së, mobilizohet për zgjedhje të reja



PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka zhvilluar të premten takim me kryesitë e degëve, ku ka diskutuar rreth mobilizimit të PDK-së për zgjedhjet nacionale. Kreu i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se PDK-ja ka pasur një pro-

ces të brendshëm zgjedhor nga i cili kjo parti është fuqizuar më tutje për t'u ballafaquar me sfidat me të cilat po kalon vendi. Veseli ka theksuar se PDK-ja është e gatshme që të hyjë në zgjedhjet nacionale dhe, sipas tij, do të ofrojë platformën më të mirë politike. "Ne kemi kaluar nëpër

një proces demokratik të brendshëm ku kemi zgjedhur strukturat tona dhe jemi të gatshëm për zgjedhje të reja dhe për çdo sfidë nëpër të cilat po kalon vendi dhe do ta ofrojmë platformën më të mirë politike", është shprehur Veseli. Ai ka shtuar se PDK-ja është e

gatshme të marrë përgjegjësi të reja në të mirë të të gjithë qytetarëve dhe do ta ofrojmë platformën më të mirë politike për qytetarët, një platformë të zhvillimit ekonomik dhe integritimit euroatlantik të Kosovës. "PDK-ja është parti e ndryshimeve të mëdha në vend, parti lidere në procese të

rëndësishme të pavarësisë dhe konsolidimit të institucioneve tona, e zhvillimit dhe e mirëqenies. Ne jemi gati që të marrim përgjegjësi të reja për vendin, për proceset që e forcojnë ekonomisht Kosovën dhe e integrojnë atë në familjen e madhe evropiane", ka deklaruar Veseli.



## A po kalon Agim Bahtiri në AAK?

PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Kryeministri në dorëheqje Ramush Haradinaj ka pritur të premten në takim kryetarin e Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtirin, me të cilin ka folur për zhvillimet e fundit politike në vend, të arriturat qeverisëse në Komunën e Mitrovicës dhe bashkëpunimin me nivelin qendror. "Mitrovica është ndër qytetet me rëndësi

ekonomike e gjeografike dhe e fokusuar në mundësitë e shumta që ofron Trepça, tashmë pasi që është funksionalizuar dhe i është dhënë fuqia e plotë si aseti kryesor i Kosovës", ka thënë Haradinaj pas takimit. Agim Bahtiri para dy ditësh është larguar nga Aleanca Kosova e Re (AKR) e cila drejtohet nga Behgjet Pacolli.



## Filloi zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës Zhur-Dragash-Brod

DRAGASH, 26 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturrës dhe Transportit, Pal Lekaj, të premten ka marrë pjesë në fillimin e punimeve për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrugës Zhur-Dragash-Brod. Ministri Lekaj ka thënë se rehabilitimi dhe zgjerimi i dy segmenteve rrugore që lidhin Zhurin me Dragashin e Brodin kanë ndikim në lëvizjen e lirë, zhvillim ekonomik dhe sigurojnë mirëqenie më të mirë për

qytetarët e kësaj ane. Ai ka shtuar se ndihet mirë që po fillon një ndryshim më se të nevojshëm, i cili nuk arriti të realizohet për 60 vjet me radhë, përkundër nevojës së madhe. Segmenti rrugor R222, Tyrbe e Pllavës-Zapluzhë, ka gjatësi mbi 12.1 kilometra, kurse ajo R114 Dragash-Brod ka gjatësi mbi 11.6 kilometra. Të dyja këto projekte janë investim i MIT-it dhe vlera e tyre është mbi 7 milionë e 100 mijë euro.



## Klubi i Motoristëve nga diaspora vizitoi FSK-në

PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Në Kazermën e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) "Adem Jashari" në Prishtinë qëndruan të premten për vizitë 40

mërgimtarë shqiptarë nga Zvicra, të bashkuar në Klubin e Motoristëve "Shqiponja". Gjatë kësaj vizite motoristët u mirëpritën nga komandanti i

Komandës së Forcave Tokësore, gjeneralbrigade Enver Cikaqi, shefi i Shtabit të KFT-së, kolonel Hasan Hoxha, si dhe nga oficerë të lartë të FSK-së.

## Vazhdon lirimi i hapësirave publike në Skenderaj

SKENDERAJ, 26 KORRIK (ER) - Komuna e Skenderajt nëpërmjet Drejtorisë së Inspektoratit ka vazhduar aksionin e lirimit të hapësirave publike në qytetin tonë. Me këtë rast janë rritur rreth 25 garazhe në hapësirën afër institucionit parashkollor "Nëna Zahide", pesë të tilla afër banesave sociale, për të vazhduar më pas edhe dhjetë të tjera në afërsi të Gjinnazit "Hamëz Jashari". Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari,

nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka thënë se shfrytëzimi i hapësirave publike në këtë komunë do të bëhet vetëm konform normave ligjore. "Veprimet e radhës të komunës, gjegjësisht Drejtorisë së Inspektoratit, që synojnë kthimin në normalitet dhe lirimin e hapësirave publike të cilat për vite me radhë janë shfrytëzuar shkel e shko. Aksioni i sotëm, që s'është fushatë e drejtuar nga askush, por punë e përditshme, për të mbrojtur hapësirat publike që

zaptohen padrejtësisht, është zhvilluar te pjesa afër çerdhës 'Nëna Zahide', në një hapësirë që kanë qenë të ndërtuara rreth 25 garazhe, pesë të tilla te banesat sociale, për të vazhduar më pas edhe 10 të tjera në afërsi të Gjinnazit 'Hamëz Jashari'. Kësisoj, askujt nuk do t'i mohohet e drejta e garantuar që të shfrytëzojë apo vendos objekte në hapësirat publike, por vetëm duke iu nënshtruar procedurave dhe rregullave që janë përcaktuar me ligj", ka shkruar Jashari.



## Në Mitrovicë ngrihet aktakuzë për falsifikim të parave

MITROVICË, 26 KORRIK (ER) - Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë kundër të pandehurit L. H., në drejtim të

veprës penale "Falsifikim i parasë", nga neni 296, paragrafi 2, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Prokuroria ka njoftuar opinionin se i pandehuri L. H., më 20 mars 2019, në Mitrovicë ka vënë në

qarkullim monedha metalike, të cilat, edhe pse e ka ditur që janë të falsifikuara, i ka përdorur në një kioskë dhe në një market për të blerë cigare. Të pandehurit, pas ndalimit nga policia, i janë konfiskuar disa monedha meta-

like, të cilat, pas ekzaminimit, kanë rezultuar të falsifikuara. Prokurori i Shtetit i ka propozuar Gjykatës Themelore në Mitrovicë që të pandehurin ta shpallë fajtor për veprën e kryer penale dhe ta dënojë sipas ligjit.





Në njëvjetorin e vdekjes përkujtohet simboli i rezistencës së çështjes kombëtare, Adem Demaçi

## Vihet gurthemeli për ndërtimin e shtatores së Adem Demaçit

Përfaqësues të institucioneve të vendit, kryetarë partish, veprimtarë të çështjes kombëtare, ish të burgosur politikë, qytetarë dhe familjarë, të premtën kanë bërë homazhe pranë varrit të veprimtarit dhe simbolit të rezistencës së çështjes kombëtare, Adem Demaçi, me rastin e njëvjetorit të ndarjes nga jeta. Po në këtë përvjetor është vënë edhe gurthemeli për ndërtimin e shtatores së Demaçit te parku që mban emrin e tij te "Rrethi i Flamurit" në Prishtinë



të lirë sot, i duhet përmasa e vendosmërisë së heroit si Adem Demaçi, për ta gjetur forcën brenda vetes, për të qëndruar konsistent në mbrojtje të interesit nacional.

Kryetari i Shoqatës së të Burgosurve Politikë, Hydajet Hyseni, ka thënë se sot na ka bashkuar Adem Demaçi, sikur na

Albin Kurti, ka bërë homazhe te varri i veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi, me rastin e njëvjetorit të vdekjes së tij. Kurti ka thënë se Adem Demaçi është disidenti më i madh evropian pas Luftës së Dytë Botërore. "28 vjet në burg. I pathyeshëm. I palodhshëm. Pas secilës burgosje e dënonin më shumë, e mbanin më gjatë. Njëherë 3 vjet, mandej 10 vjet, pastaj 15 vjet. Sot bëme homazh te varri i tij në Prishtinë, në njëvjetorin e ditës kur ndërroi jetë. Adem Demaçi ishte vetëmohim me paramendim. Ai e dinte që populli i shtypur ekziston për

aq sa reziston. Filloi si gazetar, shkrimtar dhe intelektual i ri, e kulmoi si përfaqësues i përgjithshëm politik i UÇK-së. Nuk mohonte të arriturat, mirëpo vinte theksin tek ajo që ende ngelet e përcaktuar. Ecte veçse përpara për shkak të dashurisë së madhe. Nuk shikonte prapa sepse s'urrente fare", ka thënë Kurti.

Në emër të familjes, djali i Adem Demaçit, Shqiptar Demaçi, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj dhe të gjithë bashkëveprimtarët për nderimin që po i bëjnë Adem Demaçit.

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 26 KORRIK** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kryeministri në dorëheqje Ramush Haradinaj, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje Albin Kurti, kryetarë komunash, ish të burgosur politikë, qytetarë dhe familjarë, kanë bërë homazhe të premtën te varri i veprimtarit të çështjes kombëtare me rastin e njëvjetorit të ndarjes nga jeta. Në këtë përvjetor të tij është vënë edhe gurthemeli për ndërtimin e shtatores së simbolit të rezistencës së çështjes kombëtare, Adem

punës", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Me rastin e vënies së gurthemelit për ndërtimin e shtatores së Adem Demaçit, Haradinaj ka thënë se baca Adem do të rikthehet në Prishtinë i gdhendur në bronz, për t'ua rrefyer brezave historinë e sakrificës dhe për ta mbajtur gjallë shpirtin tonë çlirimtar. "Pa fjalën e tij, që rrezatonte shpresë, njerëzit vështirë do të rreshtoheshin me lëvizjen e rezistencës dhe liria e Kosovës do të ishte vetëm ëndërr", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se atij i ndalua fjala, duke luftuar një jetë për lirinë e saj.

Haradinaj ka shtuar se veprimtarit



Demaçi, te parku që mban emrin e tij te "Rrethi i Flamurit" në Prishtinë.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë homazhe para varrit të veprimtarit Adem Demaçi, i shoqëruar edhe nga anëtarë të Rinisë Demokratike të Kosovës. Ai ka thënë se një popull që rrit personalitete si Adem Demaçi nuk e humb asnjëherë rrugën.

Ndërkaq kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka thënë se para një viti Kosova u nda nga njeriu i saj, që shkriu plot 28 vjet të jetës së tij duke e menduar lirinë. "Ademi ishte mendimtar. 10 mijë ditë prapa hekurave nuk i konsideroi të humbura, por ditë pune për Kosovën. Burgu për idealistin Adem Demaçi ishte vendi i tij i

të shquar Adem Demaçit iu shkelën të gjitha të drejtat, por ai kurrë nuk u ndal, duke krijuar drejtësi për të tjerët. Kryeministri në dorëheqje ka thënë se popullit të tij, që u është bashkuar popujve

ka bashkuar edhe në të kaluarën brez pas brezi. "Baca Adem tash e tutje do të flasë edhe në bronz dhe do të japë mesazhe siç ka dhënë brez pas brezi", ka thënë Hyseni. Edhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje,



### Shoqata e të Burgosurve Politikë do t'i botojë veprat e Adem Demaçit në 40 vëllime

Në njëvjetorin e ndarjes nga jeta të atdhetarit Adem Demaçi, të premtën është mbajtur një akademi përkujtimore, ku u tha se ai mbetet një nga figurat më të ndritshme të vendit.

Shoqata e të Burgosurve Politikë në këtë përvjetor ka bërë me dije se do t'i botojë veprat e Adem Demaçit në 40 vëllime e kjo, sipas tyre, bëhet për të dëshmuar që ai nuk ka vdekur.

Profesor Ahmet Qeriqi ka folur rreth jetës dhe veprës së veprimtarit Adem Demaçi, për të cilin ka thënë se mbetet një shembull i sakrificës shqiptare për liri e

bashkim.

Kryetari i Shoqatës së të Burgosurve Politikë, Hydajet Hyseni, ka thënë se Adem Demaçi bashkonte në mënyrë shembullore veprimtarin atdhetar, humanistin, njeriun e mirë me intelektualin dhe shkrimtarin e vërtetë. Kurse ish i burgosur politik, Selatin Novosella, duke folur për jetën e Adem Demaçit, ka thënë se ai i kishte udhëhequr në rrugën drejt lirisë për Kosovën. Ai bëri me dije se veprat e Demaçit nga Shoqata e të Burgosurve Politikë do të botohen në 40 vëllime.





# Kosova përfiton mbi 6 milionë euro grante nga WBIF

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 KORRIK - Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka njoftuar se është lajm i mirë për Kosovën që aplikimi ynë për grante në vlerë mbi 6 milionë euro u miratua nga Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF) duke e bërë Kosovën një nga vendet përfituese të Ballkanit Perëndimor. Ministria Hoxha ka theksuar rëndësinë e WBIF granteve në implementimin e projekteve që kanë për synim zhvillimin e qendrueshëm të sektorëve strategjik siç është energjia, transporti, mjedisi, si dhe zhvillimi i sektorit social dhe privat.

Ministria e Integritimit Evropian, në konsultim me bankat zhvillimore të cilat marrin pjesë përmes huadhënies, ka koordinuar procesin e përgatitjes së aplikimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës në kuadër

të thirrjes së 21-të për grante të asistencës teknike të Kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF).

Ministria Hoxha ka informuar se Komiteti Drejtues i WBIF ka njoftuar se janë miratuar aplikacionet për grante në mbledhjen e 20 të datës 25-26 qershor 2019 në Berlin. Ajo ka thënë se në kuadër të asistencës teknike për Kosovën u miratuan katër grante në nivel nacional në shumën mbi 5.5 milionë euro dhe një projekt në nivel rajonal në shumë 624 000 euro.

Kosova përfiton nga këto grante përmes këtyre projekteve: Sistemet e ngrohjes qendrore (2,010,000 euro); Plani për furnizimin me gaz dhe Shqyrtimi i kornizës rregullative dhe asistencës (1,507,500 euro); Nxitja dhe shfrytëzimi i mundësive për sigurinë e ujit në Kosovë: Ndërtimi i digës së kremenatës (1,040,000 euro); Ndërtimi dhe rehabilitimi i



infrastrukturës së kujdesit shëndetësor (1,005,000 euro) dhe REEP Plus, Dritarja 4 - Ndërtesat publike (624,000 euro).

Ministria Hoxha ka theksuar se si koordinatorë kombëtare e fondeve IPA do të vazhdojë të koordinojë asistencën zhvil-

limore në Kosovë me qëllim të implementimit të reformave që e sjellin vendin më afër Bashkimit Evropian.

## Kapen rreth 55 kilogramë marijuanë në Vërmicë

PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Dogana e Kosovës ka bërë me dije se oficerët doganorë kanë arritur të identifikojnë dhe të kapin mbi 55 kilogramë marijuanë, e cila ishte tentuar të futet në Kosovë nëpërmjet pikëkalimit kufitar në Vërmicë.

"Në orët e mbrëmjes së enjte në pikëkalimin e Vërmicës ka arritur një automjet i llojit 'Opel Meriva' me targa të Shqipërisë e drejtuar nga një shtetas shqiptar. Pas profilizimit nga oficerët doganorë automjeti është ndaluar për kon-

troll të dyfishtë. Në kuadër të Menaxhimit të Integruar të Kufirit është kryer kontroll e përbashkët me Policinë e Kosovës dhe Njësitin Antikontrabandë ku gjatë kontrollit është dyshuar se automjeti në fjalë ka dysheme të dyfishtë në të

cilën mund të kishte mallra të ndaluar. Pas hapjes së dyshemesë janë hasur 53 paketime të substancës narkotike të dyshuar marijuanë (29 paketime marijuanë dhe 24 paketime marijuanë 'çokollatë'). Pësja e kësaj sub-

stance narkotike është 54 kilogramë e 963.24 gramë", ka njoftuar Dogana e Kosovës. Sipas këtij njoftimi, drejtuesi i automjetit është arrestuar dhe rasti është përcjellë tek Policia e Kosovës për trajtim të mëtejshëm.



## Shala: Kosova mund të hapë deri në 50 mijë vende pune në fushën e IT-së

PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Ministri në detyrë i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer Shala, ka vizituar të premtën Parkun e Teknologjisë, "TechPark Prishtina", ku nga afër është njoftuar për punët që po bëhen për funksionalizimin e tij. Sipas tij, "TechPark Prishtina", do t'u shërbejë kompanive inovative të cilat krijojnë

produkte të reja dhe mundësojnë rritjen e eksportit të shërbimeve. "Sot Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm për rritje të eksportit në IT, por kemi nevojë të investojmë shumë më tepër në zhvillimin e shkathhtësive të rinjve në vendin tonë, i cili edhe është fokus yni në ministri", ka thënë Shala.

Gjatë kësaj vizite Shala ka thënë

se do t'i ndihmojnë kompanitë që të zhvillohen, ta rrisin eksportin, si dhe të gjenerojnë punësim dhe zhvillim ekonomik. "Kosova mund të gjenerojë deri në 50 000 vende pune vetëm në fushën e IT-së brenda dhjetë vjetëve të ardhshëm dhe do të punojmë sa më shumë që ta arrijmë këtë", u shpreh Shala.





# Vetëvendosja kërkon nga Bordi i Telekomit mos t'ia vazhdojë kontratën 'Z-Mobile'-s

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 26 KORRIK - Edhe katër ditë kanë mbetur nga kalimi i afatit për mosvazhdimin e kontratës në mes të Telekomit të Kosovës dhe 'Z-Mobile', pra 30 korrik 2019. Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu dhe Fatban Bunjaku, në një konferencë për media të premtën kanë thënë se ende nuk ka asnjë vendim nga bordi i Telekomit të Kosovës në lidhje me këtë çështje.

Ata kanë thënë se kjo heshtje është tejet shqetësuese për

katër ditë kaq vendimtare, ndërkohë që pas shtjellimit deri në detaje të kontratës së Telekomit me "Z-Mobile" në komisionin hetimor parlamentar nuk ka më asnjë dyshim mbi masë e dëmit të tij. "Tanimë është e qartë se kemi të bëjmë me një kontratë ku 'Z-Mobile' e ka të hapur derën të marrë sa të dojë nga Telekomit i Kosovës, ta shesë me çfarëdo çmimi që dëshiron dhe të japë 27 përqind të atyre të hyrave, pa e pasur fare në konsideratë që kostoja e atyre shërbimeve mund të jetë shumë më e lartë", ka thënë deputeti Liburn Aliu.

Ai ka thënë se kjo kontratë nuk duhet të vazhdohet me asnjë kusht, por menjëherë duhet të fillojnë procedurat për kthimin e fondeve të plaçkitura përmes saj. "Deri të hënën, bordi i Telekomit të Kosovës duhet të marrë vendim për mosvazhdimin e kontratës, të njoftojë 'Z-Mobile' për këtë vendim si dhe ta informojë opinionin për këtë vendim", është shprehur Aliu. Ai ka theksuar se "Vala" është dëmtuar së fundmi edhe moralisht me paraqitjen e dobët që i kanë shkaktuar mbingarkesat abuzive të 'Z-Mobile'. Fatban Bunjaku gjatë konfer-

encës ka thënë se kontrata e Telekomit me 'Z-Mobile', më e pashembullta që e ka njohur sektori i komunikimeve elektronike në botë, e ka dëmtuar 'Valën' dhe e ka çregulluar të gjithë tregun e telefonisë mobile në vend. "Nga raporti i paraqitur prej profesionistëve të Telekomit në Komisionin Hetimor Parlamentar, dëmi i drejtpërdrejtë që 'Z-Mobile' i ka shkaktuar Telekomit llogaritet: 107 milionë euro humbje reale të deklaruara për Telekomin, ndërkohë që 'Z-Mobile' ka pasur rreth 73 milionë euro të hyra bruto; mbi 140 milionë

euro llogariten të hyrat e munguara për Telekomin si pasojë e kësaj kontrate; humbjet financiare disa milionëshe për shkak të thirrjeve të humbura dhe largimit të konsumatorëve si pasojë e mbingarkesës së shkaktuar nga shërbimet pa limit të 'Z-Mobile'; numrat e 'Z-Mobile' janë evidentuar në krye të vjedhjes në ridrejtim të trafikut hyrës ndërkombëtar, që nga publiku njihet si afëra 'SIM-to-SIM'. Vetë rendi publik rrezikohet të lëkundet nga kapja kriminale e sektorit të komunikimeve elektronike", ka thënë Bunjaku.



## Mehmeti dhe Istrefi diskutuan për infrastrukturën ligjore të BQK-së

PRISHTINË, 27 KORRIK (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka pritur të premtën në takim Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, Sami Istrefi. "Në frymën e bashkëpunimit të dyinstitucioneve, duke u bazuar në mandatet ligjore që kanë të dy institucionet, u diskutua avancimi dhe thellimi i

bashkëpunimit në mes të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Avokatis të Përgjithshëm të Shtetit të Kosovës, me fokus të veçantë çështjet e fushës ligjore. Guvernatori Mehmeti ka falënderuar avokatin Istrefi për gatishmërinë e bashkëpunimit me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe u zotua që ky bashkëpunim do të

vazhdojë në të ardhmen. Gjithashtu, ai e ka informuar Istrefin për zhvillimet, aktivitetet dhe angazhimet e BQK-së dhe të sektorit financiar. Ndërsa Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, Sami Istrefi, ka vlerësuar lart sukseset e arritura në sektorin financiar dhe ka konfirmuar gatishmërinë për avancimin e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve.





Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (4)

# ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti Selatin  
NOVOSELLA**

Në emër të familjes së Mustafë Sopotit, ju shprehim ngushëllime për Veprimtarin e shquar të Kombit Shqiptar!

27 korrik 2018,  
(emri i palexueshëm) Sopi

Baca Adem tani i takon përjetësisë, sepse ishte mik me krejt trojet shqiptare!

27 korrik 2018,  
Igballe Rexha-Jashari

Vetëm ai që e ka njohur shumë do mund të thoshte deri diku se sa ka punuar dhe sa i ka rrahur zemra Bacës Adem për Shqipërinë!

27 korrik 2018,  
(emri i palexueshëm)

I gjallë në jetë të jetëve!

27 korrik 2018,  
Shqiptar Rexha

Me nderime të larta Bacës Adem që e deshëm shumë e nuk do ta harrojmë përjetë, Familja Ramadani!

27 korrik 2018,  
Adelina Ramadani

I përjetshëm kujtimi për ty! Mburrem që të njoha!

27 korrik 2018,  
Lule Ramadani

Ngushëllime nga Doruntina dhe Ardita!

27 korrik 2018,  
Familja Ahmeti

Lavdi veprës Tënde, i madhi Baca Adem!

27 korrik 2018,  
Sabile Keçmezi-Basha

Do të mbetesh i pavdekshëm me punën dhe veprën, në epokën në të cilën jetove.

27 korrik 2018,  
Tefik Basha

Jemi rritur me idealet tua, se si duhet atdheu, kombi... Ti bacë, je vet pavdekësia... Do të kujto-

jmë sa herë që atdheut i kanoset rreziku, KOLOSI YNË, Baca Adem!

27 korrik 2018,  
Vlorë Baraliu, Dobrajë

Të patëm idhull gjatë veprimit të fshehtë kundër Jugosllavisë, të patëm udhërrëfyes gjatë luftës çlirimtare, të patëm simbol të lirisë!

27 korrik 2018,  
Të kujton: Komandanti i ZON gjeneralmajor (nën. i palex.)

Bacë, Adem Demaçi!  
Ishe Feniks që u ringjalle nga hiri i popullit sa herë historia na kishte vënë buzë zhdukjes! Emri dhe vepra juaj nuk shuhen kurrë! I përjetshëm goftë kujtimi për prijatarin e luftës për bashkimin kombëtar, Adem Demaçin! Prehu në përjetësinë e amshimit me shokët e idealit! LAVDI!

27 korrik 2018,  
Afërdita Dervishi, prof. Universiteti

Çfarëdo që të themi për Ty Bacë, nuk kemi thënë mjaftë! Veprime drejt si njeri, veprime drejt në çdo kohë dhe shkove si kristali! Lavdi!

27 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem Demaçi,  
Jetove dhe veprime vertikalisht gjithë jetën! Lavdi veprës tënde jetësore! Edhe ne ta paçim borxh ëndrrën - bashkimin kombëtar!

27 korrik 2018,  
Me respekt Shukrije Gashi, bashkëthemeluese e KMDLNJ-së

Adem Demaçi për shqiptarët ka qenë e do të mbetet "Ujëvara e Niagarës" që në mesin e tyre ka derdhur va-zhdimisht frymëzimin e çlirimit dhe të bashkimit kombëtar. Qoftë i përjetshëm kujtimi i tij!

27 korrik 2018,  
Xhevat, Hasan, Emri dhe Ylber Hasani

Bacë, të qoftë i lehtë dhe i Kosovës dhe ishalla Allahu na bashkon në xhenet!

27 korrik 2018,  
Mehdi Havolli

Baca Jem i Madh,  
Vetëm për Ty fjalët qenkan pak. Ti Burrë i Madh i Shqipërisë së Madhe! Ishim me fat që të patëm në mesin tonë!

27 korrik 2018,  
Familja Makolli

Adem, ishim bashkë-ike me le vetëm! Do të më mungosh!

27 korrik 2018,  
Nezir Gashi

Ishe dhe mbetesh idhull për ne rininë! Të patëm e do të kemi udhërrëfyes!

27 korrik 2018,  
(emri i palexueshëm)

I përjetshëm kujtimi për Ikonën kombëtare!

27 korrik 2018,  
Asllan Qyqalla

Me shumë respekt, Bacës Adem!  
Një jetë të tërë në shërbim të çështjes kombëtare, i paluhatshëm, i bindur për fitore!

27 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem, po qajnë lule e ferra e mali, po qanë mbarë populli shqiptar, mbarë vatani. Baca Adem o burrë dai Shqipërinë u mundove ta bësh shqiptare. Lavdi të goftë e të goftë i lehtë dhe i Kosovës. Prehu në këtë liri që kemi.

27 korrik 2018,  
Adem Mrasori, fshati Mrasor, Rahovec

Zoti e mëshiroftë këtë burrë të madh, me zemër të madhe. I lehtë të goftë dhe i Kosovës, o Baca Adem!

27 korrik 2018,  
(emri i palexueshëm)

Frymëzim për çdo gjeneratë! Lavdi!

Baca Adem, të kanë ardhur vëllezërit nga të gjitha trevat shqiptare. Ashtu siç e deshe Ti dhe vepra e juaj për një bashkim kombëtar. Ju ishit simbol i rezistencës, lirisë dhe sakrificës me dekada. Ne jemi sa një pikë uji, por kemi qenë gjithherë në përkrahjen e juaj. Ju qoftë i lehtë dhe i kombit shqiptar!

27 korrik 2018,  
Ramadan Rizani, Krojmir

Te përcjellim me nderime! Ti Bacë shkove, por kurrë s'kemi me të harrua!

27 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm),  
Shalë, Drenicë

Baca Adem, kujtimi për Ty do të mbetet përherë frymëzim për gjeneratat e ardhshme se si duhet flijuar për atdheun dhe



për kombin! Lavdi!

27 korrik 2018,  
Ymer Hasi

Baca Adem ka me mbetur Histori për Kosovën. Veprat e këtij burri kurrë nuk harrohen. Për Kosovën u kanë gjithmonë! Allahu në xhenet e goftë!

27 korrik 2018,  
Muhamet Rama 2.2.1945,  
Dubovc, Vushtrri

Baca Adem Demaçi - Të qoftë dhe i lehtë në botën tjetër të largët. Vdekja juaj është dhembje madhe dhe pikëllim i tërë popullit shqiptar. Faqebardhë të mori vdekja nga dheu i tokës-në Kosovë që luftove dhe sakrificat jote ishte nderi i shtetit tonë të Ri. Ngushëllime tërë Kosovës dhe pikërisht familjes së tij.

27 korrik 2018,  
Shqipe Hasani (L.SH.K), poete

Baca Adem,  
Nuk po më dhimbsete Ju që shkuat në amshim, sepse dhatë gjithçka nga vetja juaj për kombin dhe atdheun. Por, po më

dhimbsete ata që të arrestuam, të dënuan për lloj-lloj veprash me propagandë kundër neve e juve. Po më "dhimbsete" edhe ata që thanë se kishe pushuar në Beograd e gjetiu!

27 korrik 2018,  
Naim Bujupi, Drenas

Baca Adem,  
Përjetësisht do të mbetesh simbol i rezistencës sonë kombëtare. Të qoftë i lehtë dhe i Kosovës. Pushofshi në paqe!

27 korrik 2018,  
Zef Shala, Shoqata "Nëna Tereze"

Bacë, do jetojmë me kujtimin dhe veprat tuaja përjetësisht!

27 korrik 2018,  
(emri i palexueshëm)


Ju, krenaria dhe frymëzimi ynë! Gjatë do jetoj vepra juaj!  
"Jetë të gjatë Flamur e Shqipe"

27 korrik 2018,  
Ajshë Muriqi-Fetaj  
(Vazhdon në numrin e ardhshëm)



Fizika simetrike, udhëtim drejt universit (11)

# Antifusha elektrostатike



**Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan**

Nga kjo përzierje në bërthamën e protonit formohet një ngarkesë elektrike pozitive në brendësi të fenomenit të tornados, sepse sasia e kuartit pozitiv ( $2/3u$ ) është shumë më e madhe sesa sasia e kuartit negativ ( $-1/3d$ )

Prandaj këtu kemi thujse të njëjtin reaktion sikur te toka, ku mbi polet magnetike të magnetit tërhiqet pjesa e tjetër e hekurit (Fe) likid me ndihmën e fushës magnetike dhe fenomenit të tornados elektromagnetike.

Forca tërheqëse e bërthamës pozitive të protonit së bashku me forcën tërheqëse të fenomenit të tornados, pjesën tjetër të kuarteve pozitive ( $2/3 u$ ) e tërheqin dhe vendosin në anën e poshtme dhe të epërme mbi përzierjen e kuarteve negative ( $-1/3 d$ ) dhe pozitive ( $2/3 u$ ) (shih figurën 43 a).

Sikur në eksperimentin numë 6 ku mbulimi i poleve magnetike me elementin e hekurit (Fe) shkakton rritjen e intensitetit të fushës magnetike ((B)) ? brenda cilindrit magnetik dhe pllakave të hekurit (Fe), ashtu edhe këtu paraqitet i njëjti fenomen.

Në momentin kur kuartet pozitive ( $2/3 u$ ) tërhiqen dhe vendosen mbi polet e bërthamës pozitive të protonit, e cila formohet gjatë përzierjes së kuarteve ( $-1/3 d$ ) dhe ( $2/3u$ ) ngarkesa elektrike që kalon përtej shtresës së kuarteve ( $2/3 u$ ), shih figurën 43 b.

Në këtë rast kjo rritje e ngarkesës elektrike pozitive në bërthamën e protonit duhet të kalojë përtej shtresës së kuarteve pozitive ( $2/3 u$ ) dhe të shpërndahet, ngjashëm sikur që shpërndahet fusha magnetike që buron nga trupat qiellorë.

Në këtë mënyrë, një pjesë e ngarkesës elektrike pozitive arrin të kalojë përtej kësaj shtrese të kuarteve ( $2/3 u$ ) dhe ka vlerë elektrike pozitive e  $=1,6 \times 10^{-19} C$ .

Nga kjo ngarkesë elektrike pozitive që buron nga mbulesa e kuarteve pozitive formohet fusha elektrostатike pozitive e protonit ( $+E_P$ ), e cila fushë ka kah të njëjtë drejtim të njëjtë me vijat e ngarkesës elektrike që burojnë nga bërthama e elek-

tronit.

Kurse, pjesa e tjetër e vijave të ngarkesës elektrike pozitive nga bërthama e protonit, për shkak të rritjes së intensitetit të ngarkesës elektrike pozitive nuk mund ta kalojë shtresën e kuarteve pozitive ( $2/3 u$ ) dhe do të shpërthejë nga anët anësore të përzierjes së kuarteve, ashtu sikur që buron fusha antimagnetike te trupat qiellorë.

Këto vija të ngarkesës elektrike që burojnë nga anët anësore formojnë fushën antielektrostатike të protonit ( $+E_P$ ), e cila ka intensitet të ndryshëm, drejtim të njëjtë dhe kahje të kundërt me fushën elektrostатike pozitive të protonit ( $+E_P$ )

Antifusha elektrostатike e protonit ( $+E_P$ ) edhe pse buron nga një ngarkesë pozitive, i ka të gjitha vetitë e fushës elektrostатike negative sikurse që i posedon elektroni. Sepse, nëse llogaritet në formë matematikore, dy shenja me simbole të kundërta negative dhe pozitive na japin simbolin negativ ( $+E_P$ ) = ( $-E_P$ ) ku ( $-E_P$ ) është fusha anti elektrostатike e protonit.

## Mënyra e formimit të antifushës elektrostатike

Për ta kuptuar më thjeshtë këtë fenomen, marrim dy vija të ngarkesave pozitive (a) dhe (b). Vija (a), me ngjyrë të zezë, arrin ta kalojë shtresën e kuartit pozitiv duke formuar vija të fushës elektrostатike pozitive të protonit, kurse për dallim nga vija (a), vija (b) me ngjyrë të kuqe, nuk mund ta kalojë këtë shtresë të kuartit pozitiv ( $2/3 u$ ) dhe do fillojë të devijojë nga ana anësore (shih figurën 44).

Kjo vijë e fushës (b) ka drejtim të njëjtë, intensitet të ndryshëm dhe kah të kundërt me vijat e fushës elektrostатike. Prandaj këtë fushë të protonit që buron nga anët anësore do ta quajmë fushë antielektrostатike të protonit dhe shënohet ( $-E_P$ ).

## Përfundim

Siç shihet, nga e njëjta ngarkesë pozitive e protonit njëkohësisht burojnë dy fusha. Fusha elektrostатike e protonit ( $+E_P$ ) dhe antifusha elektrostатike e protonit ( $-E_P$ ), shih figurën 45 a. Kështu që protoni si një ngarkesë pozitive merr këtë formë, shih figurën 45 b. Fusha antielektrostатike e protonit ( $-E_P$ ) edhe pse buron nga një ngarkesë pozitive, ajo mund të konsiderohet si një fushë elektrostатike (negative) ngjashëm sikur fusha elektrostатike e elektronit ( $-E_N$ ). Siç po shihet fusha antielektrostатike e protonit ( $-E_P$ ) ka ngarkesë të njëjtë elektrike sikurse fusha elektrostатike e elektronit ( $-E_N$ ). Të dyja këto




Fig 43a



Fig 43b




Fig 44




Fig 45a




Fig 45b




Fig 46

fusha kanë intensitete të ndryshme, drejtime të njëjta dhe kahe të ndryshme.

## Konkludim

Fusha antielektrostатike e protonit ( $-E_P$ ) është e vetmja dhe e vetmja forcë që i kundërvihet forcës tërheqëse ndërmjet protonit dhe elektronit. Kjo fushë e pazbuluar dhe e padiktueshme e parandalon goditjen e drejtpërdrejtë të elektronit me bërthamën e atomit përkatësisht me protonin.

## Elektroni

Elektroni është një grimcë e ngarkuar me elektricitet negativ. Sikurse që nuk mund ta kemi një proton me energji pozitive pa ndonjë forcë që e aktivizon atë energji pozitive, ashtu nuk mund ta kemi as një elektron me energji negative pa një forcë që e shkakton atë energji negative. Dallimi i vetëm thelbësor ndërmjet elektroneve dhe protoneve

është te lloji i kuarteve nga të cilat krijohen protonet dhe elektronet, sepse te elektronet kemi më shumë kuar-te negative se sa pozitive.

Prandaj, bazuar në këtë argument mund të themi se, elektroni është një grimcë e ngarkuar me energji negative dhe për dallim nga protoni, elektroni përbëhet zakonisht nga dy kuar-te negative (quarks) poshtë (down) dhe një kuart pozitiv (quarks) lart (up) ( $-2/3 d$ ) poshtë (down), ( $-2/3 d$ ) poshtë (down) dhe ( $1/3 u$ ) lart (up)

Që do të thotë se sasia e kuar-teve negative te elektroni është e kundërta e kuar-teve pozitive te protoni, kështu që gjatë reaksioneve të ndryshme brenda strukturës së brendshme të elektronit kjo ngarkesë mbetet e ngarkuar me elektricitetet negative.

Ngjashëm sikur te protoni, fenomeni i tornados e bënë përzierjen e njërit kuart pozitiv ( $1/3u$ ) me njërin nga kuartet

negative ( $-2/3d$ )ku sasia e kuartit me vlerë negative është shumë më e madhe sesa ajo e kuartit pozitiv.

Nga kjo përzierje, në bërthamën e elektronit formohet një ngarkesë negative në brendësi të fenomenit të tornados, sepse sasia e kuartit negativ ( $-2/3d$ )është shumë më e madhe sesa ajo e kuartit pozitiv ( $1/3u$ ) Prandaj, këtu kemi thujse të njëjtin reaktion sikur te Toka, ku mbi polet magnetike të magnetit tërhiqet pjesa e tjetër e hekurit (Fe) likid me ndihmën e fushës magnetike dhe fenomenit të tornados.

Forca tërheqëse e bërthamës negative të elektronit së bashku me forcën tërheqëse të fenomenit të tornados, pjesën tjetër të kuarteve negative ( $-2/3 d$ ) e tërheqin dhe vendosin në anën e poshtme dhe të sipërme mbi përzierjen e kuarteve pozitive dhe negative ( $1/3 u$ ) dhe ( $-2/3 d$ ) ngjashëm sikur i njëjti proces që është zhvilluar të protoni (shih figurën 46). **Vijon.**



## Pas 16 vjetësh ShBA-ja rifillon ekzekutimet e të dënuarve me vdekje

UASHINGTON, 26 KORRIK - Shtetet e Bashkuara do të ekzekutojnë pesë persona të cilët janë të dënuar me vdekje. Këtë e konfirmoi të enjten prokurori i përgjithshëm William Barr, i cili tha se pesë të burgosur, të cilët janë të dënuar me vdekje, do të ekzekutoheshin, transmeton "REL". Ata janë të dënuar për vrasje ose dhunime të fëmijëve

apo të moshuarve, tha kreu i Departamentit të Drejtësisë. Ekzekutimet janë planifikuar për dhjetor të vitit 2019 dhe janar të 2020-s.

Njoftimi heq një moratorium joformal mbi dënimin me vdekje, që nga ekzekutimi i vitit 2003 i Louis Jones Jr, një veteran i Luftës së Gjirit i cili vrau një ushtar 19-vjeçar, Tracie Joy McBride.

Vendimi i qeverisë federale të ShBA-së, për t'i rifilluar ekzekutimet e dënimeve me vdekje, pas një pauze 16-vjeçare, ka ngjallur kritikë nga grupet e të drejtave të njeriut dhe udhëheqësit demokratë.

Disa kandidatë për nominimin e demokratëve për garën presidenciale të vitit 2020 kërkuan që dënimet me vdekje të hiqet.



## Vala e të nxehtit rrezikon shkrirjen e akullit në Grenlandë

NUUK, 26 KORRIK - Vala e të nxehtit që ka përfshirë disa pjesë të Evropës duket se do të bartet në Grenlandë, duke rrezikuar shkrirjen e shtresës së dytë më të madhe të akullit në botë, kanë thënë Kombet e Bashkuara të premtën.

Ajri i nxehtë që është bartur nga Afrika Veriore ka rritur temperaturat evropiane më 25 korrik për 2, 3 apo 4 gradë celsius, ka thënë zëdhënësjja e Organizatës Botërore për Meteorologji, duke e përshkruar këtë fenomen si "absolutisht të pabesueshëm".

Nullis ka thënë në një takim të

OKB-së në Gjenevë se, "sipas parashikuesve, lëvizjet atmosferike tani do ta bartin nxehtësinë drejt Grenlandës" çka mund të rezultojë me shkrirje të shtresës së akullit nën rekordin fillestar më 2012. "Ende nuk e dimë sigurt nëse do të tejkalohet rekordi i vitit 2012, mirëpo është afër", ka thënë ajo.

Shtresa e akullit në Grenlandë është pjesë kyçe e sistemit global klimatik andaj shkrirja e saj do të rezultonte me rritje të nivelit të detit dhe ndryshime të tjera klimatike.

Akulli në Grenlandë është shkrirë



me shpejtësi të madhe në javët e fundit, ka thënë Nullis, duke përmendur të dhënat nga një

shkencëtar për klimën. "Vetëm në muajin korrik janë humbur 160 miliardë tonë të akullit për shkak

të shkrirjes. Kjo është e barabartë me 64 milionë pishina olimpikë", ka shtuar ajo.

Parisi ka regjistruar temperaturën më të lartë ndonjëherë më 25 korrik, 42.6 gradë celsius, derisa alarmi i kuq i nivelit më të lartë është lëshuar në veri të Francës.

Belgjika, Gjermania, Luksemburgu dhe Holanda po ashtu kanë regjistruar rekord të temperaturave, 41.8 gradë celsius, 41.5 respektivisht 40.7 gradë celsius.

Ndërkohë Britania ka shënuar temperaturën më të lartë për muajin korrik, 38.1 gradë celsius.

## OKB: Komuniteti ndërkombëtar ka dështuar që të përballet me krizën në Siri

NYU JORK, 26 KORRIK - Shefja për të Drejtat e Njeriut në Kombet e Bashkuara, Michelle Bachelet, ka thënë se qeveria siriane dhe aleatët e saj kanë vazhduar fushatën kundër civilëve në veriperëndim të Sirisë, pavarësisht prej paralajmërimeve të komunitetit ndërkombëtar për përshkallëzim të dhunës.

Ofensiva ushtarake e qeverisë siriane, e përkrahur nga Rusia ka nisur më 30 prill, kundër bazës së fundit të udhëhequr nga rebelët, në të cilën gjenden 3 milionë persona.

Si pasojë e konfliktit besohet se 440 000 persona janë zhvendosur nga kjo zonë.

Zyra e Bachelet ka thënë se në



dhjetë ditë e fundit janë vrarë 103 civilë, duke përfshirë 26 fëmijë. Bachelet ka thënë të premtën se kombet më të fuqishme në botë janë duke dështuar që të përballet me krizën në Siri, e cila ka rezultuar "tragjedi të shkallës së lartë".

## Erdogani: Sistemet ruse S-400 do të funksionalizohen në prillin e ardhshëm

ANKARA, 26 KORRIK - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka përsëritur se Turqia planifikon funksionalizimin e sistemeve ruse për mbrojtje S-400 në muajin prill. "Në pranverën e ardhshme, me dëshirën e Zotit, në prill të vitit 2020 ne do të jemi në gjendje ta fillojmë funksionalizimin e këtij sistemi", ka thënë Erdogan gjatë një takimi në Partinë e tij për Zhvillim dhe Drejtësi në Ankara. Zyrtarët amerikanë dhe ata të NATO-s kanë kundërshtuar blerjen e sistemeve ruse nga ana e Turqisë, duke thënë se nuk është në përputhje me sistemet



e aleancës ushtarake dhe do t'i rrezikojë aeroplanët e rinj F-35, që përdoren nga Perëndimi. Shtetet e Bashkuara kanë thënë se Rusia do të jetë në gjendje të përfitojë të dhëna të ndjeshme për aeroplanët F-35, nëse ata përdorën bashkë me sistemet ruse.

Rusia ka nisur dërgimin e sistemeve ruse në Turqi gjatë këtij muaji, derisa Uashingtoni është përgjigjur duke larguar Turqinë nga programi i tij i aeroplanëve F-35.

Erdogan, po ashtu, ka thënë se Turqia do të kërkojë diku tjetër

aeroplanë luftarakë nëse Shtetet e Bashkuara nuk do t'i shesin aeroplanët F-35. "Asnjë kërcënim apo sanksione kundër Turqisë, sidomos kërcënimet se Turqia do të largohet nga projekti F-35, nuk do ta parandalojnë shtetin tonë që të ketë prioritete të sigurisë", është shprehur ai.

## Johnsoni: Marrëdhëniet mes ShBA-së dhe Britanisë do të jenë 'sensacionale'

LONDËR, 26 KORRIK - Marrëdhëniet në mes të Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara do të jenë "sensacionale" tani që Boris Johnson është kryeministër i Britanisë, ka thënë ambasadori amerikan në Mbretërinë e Bashkuar, Woody Johnson. Ai i ka thënë "BBC"-së, se të dy kanë shumë të përbashkëta sa i përket stilit të udhëheqësisë së tyre dhe

kërkojnë që "gjërat të kryhen". Sipas tij, një Brexit pa marrëveshje nuk do të ndikojë në aftësinë e Britanisë për të nënshkruar një marrëveshje tregtare me ShBA-në.

Presidenti amerikan ka mirëpritur lajmin për ngritjen e Johnsonit në detyrë, duke thënë se ai do të bëjë "punë të mrekullueshme pas, sipas tij, ai është "Trumpi i

Britanisë".

Një mbështetës i idesë së largimit të Britanisë nga Bashkimi Evropian, Trump ka qenë kritik i ish-kryeministres britanike, Theresa May, sa i përket negociatave me bllokun evropian. Në mes tyre ka pasur tensione edhe për ndryshimet klimatike, si dhe rreth qëndrimeve të presidentit amerikan për racën dhe imigrimin.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:**

**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**



E jashtëzakonshme


# Supergrabitje në aeroport, vidhen 30 milionë dollarë ari

Një grup njerëzish të armatosur grabitën një ngarkesë me ari dhe metale të tjera të çmuara me vlerë të paktën 30 milionë dollarë në një aeroport në Brazil të enjten. Të paktën tetë persona hynë të armatosur në terminalin e ngarkesave në aeroportin ndërkombëtar Sao Paulo-Guarulhos. Ata hynë në aeroport me dy kamionë që ngjanin me ato të policisë federale



braziliane, ka raportuar "Reuters". Grabitësit u larguan nga aeroporti me të paktën 750 kilogramë ari dhe metale të tjera që do të dërgoheshin në Zurich dhe Nju Jork.

FOTO E DITES




Disa qytetarë në Hanover të Gjermanisë shihen duke pushuar në liqenin Altwarmbuchener. Fotografia është bërë nga Christophe Gateau. /AFP/

E rrallë

# Krijesa e vetme që jeton në përjetësi

La 'turritopsis dohrnii', një specie e vogël e kandilit të detit të Mesdheut, është i njohur si "kandili i pavdekshëm". Falë aftësisë së tij, kjo krijesë e vogël ruan sekretin e vërtetë të biologjisë së pavdekësisë. Rreth kësaj krijese është fantazuar për shekuj me radhë. Letrat nga kulturat e shumta përmbajnë një sasi të pafundme mitesh dhe tregimesh rreth saj, por



deri në mes të viteve 1990 nuk kishin gjetur asnjë dëshmi se përjetësia në planetin tonë ishte e mundur.

## BARSOLETA E DITËS



- Bir, jam rrëzuar sot dhe shyqyr e theva dorën e djathtë.
- Pse?
- Se unë shkruaj me dorën e majtë.




### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Nga dita e diele ne ora 14:00 dhe 18:00  
**"Spider-Man Far From Home" 3D,**

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min  
 Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts




Nga dita e diele ne ora 22:00  
**"STUBER"**

Aksion/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: Kumail Nanjiani, Dave Bautista, Iko Uwais, Natalie Morales, Betty Gilpin, Jimmy Tatro, with Mira Sorvino, and Karen Gillan

Regjia: Michael Dowse




Në ora 20:00

**"THE LION KING" 3D**

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

Rolet: Donald Glover, Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyonce Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver

Regjia: Jon Favreau




Nga dt. 08.08.2019

**"THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"**

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

Regjia: Thurop Van Orman



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/KinoABC).

 <p><b>DASHI</b> Edhe pse në sektorin e punës nuk duken gjërat mirë, miqësia është ajo që ka kulmin e ditës sot. Do të keni shkëndija me një mik të vjetër.</p>	 <p><b>DEMI</b> Edhe pse ju pëlqen të qëndroni në familje, sot mendjen e keni te një udhëtim pune që mund të vendosë shumë gjëra për të ardhmen tuaj.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Do të ketë kundërshti të hapura në ambientin miqësor sot, por është më mirë kur ka debat dhe kur dëgjojen të gjitha palët.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Sot të gjithë janë kundër të gjithëve, por në fund ju do të pësoni humbjet më të mëdha si emotive ashtu edhe shoqërore.</p>	 <p><b>LUANI</b> Thjesht fakti që jeni të qetë sot po ju pëlqen pa masë. Gjithë dita do të kalojë në shoqërinë e partnerit që është më pasionant se zakonisht</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Harmonia, fati dhe ndjenjat janë çdo gjë që prisni sot dhe do ta keni me bollëk. Ju pëlqen ndjesia e të qenit mirë me veten.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Dëshira dhe ndjenja që nuk ju kthehen në mënyrë reciproke do të bëjnë që sot të ndiheni të përhumbur dhe të mbyllur.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Lajmet që do të merrni sot do t'ju vënë në dilemë të thellë lidhur me një vendim që keni marrë kohët e fundit. Mbase do të ndryshoni mendje.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Autokontrolli i tepërt ju ka bërë që shumë herë t'i humbisni shanset për çështje vërtet të rëndësishme. Mundohuni të mos veproni njësoj sot.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Edhe pse ka shumë trysni në ambientin që ju rrethon do të dini se si ta shijoni në maksimum ditën tuaj. Çdo gjë shkon siç dëshironi.</p>	 <p><b>UJORI</b> Dita paraqitet shumë e qetë dhe e këndshme, përveç ndonjë hatërmbetje me partnerin. Gjithsesi do të dini t'i rimerrni pozicionet e mëparshme.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Impenjimet e shumta të ditës ju kanë lodhur dhe sot do të kërkon vetëm të pushoni. Qetësia e një vendi të ngrohtë do të jetë shpëtimi juaj.</p>



## Katy Perry tregon se është zhytëse e zonja

**K**aty Perry, përpos që është këngëtare shumë e mirë, duket se është edhe një zhytëse shumë e zonja. Këngëtarja e "Never Really Over" është duke shijuar pushimet me të fejuarin e saj Orlando Bloom në Mallorca të Spanjës, ku ajo është fotografuar derisa ka kërcyer në ujë nga një shkëmb. 34-vjeçarja Perry dukej mrekullueshëm me një parë bikine të zeza me pika të bardha.



## Reperi i famshëm lidhet me ish të dashurën e djalit



**P**rej ditësh në mediat rozë amerikane ka bërë bujë një lajm ku thuhet se reperi i njohur Diddy është në një marrëdhënie me ish të dashurën e të birit. Mediat e huaja raportojnë se pas ndarjes së

Lori Harvey nga i biri i reperit, Diddy dhe Lori janë parë shumë shpesh së bashku duke mbështetur njëri-tjetrin në çështjet profesionale dhe private, dhe një foto e kapur mat duket se i ka përforcuar edhe dyshimet.




## Selena Gomez feston ditëlindjen me një fustan 50 dollarësh

**S**elena Gomez e ka pritur ditëlindjen e saj të 27 me stil. Ylli i muzikës pop është në Romë të Italisë bashkë me miqtë dhe producentin e filmit Andrea Iervolino për ta festuar ditëlindjen e saj. Gomezi kishte zgjedhur për

këtë rast një fustan të gjatë dhe të thjeshtë. Këngëtarja e "It Ain't Me" është parë duke ngrënë drekë në Pierlugi bashkë me miqtë e saj, e veshur me fustanin "Wrinkle Look" të markës "Zara" që kushton vetëm 49.90 dollarë.

## Ngrihet aktakuzë ndaj ASAP Rocky

**A**SAP Rocky është akuzuar për sulme dhe dëmtim trupor në Suedi dhe do të mbetet në paraburgim derisa të zhvillohet një gjyq. Raeperi, emri i vërtetë i të cilit është Rakim Mayers, u arrestua në Stokholm në fillim të korrikut. Dy personat e arrestuar me të janë akuzuar gjithashtu për sulmin. Gjykimi pritet të fillojë më 30 korrik.





# ZOTI E BEKOFTË 'AMERIKËN'! TË GJITHË JEMI 'AMERIKANË', TË GJITHË JETOJMË NË 'AMERIKË'!?

Për Koloseumin shqiptar dhe tjetërsimin kulturor; për kombin virtual shqiptar dhe mungesën e patriotizmit; për anën e ndritshme të Amerikës që shqiptari s'e do dhe për trinitetin shqiptar të mbijetesës në kaosin e vlerave: zbavitje, trivialitet dhe harresë!



AGRON SHALA

Dikur, në shkollat e Kosovës të kohës së monizmit, vlerësohej lart definicioni për kombin që e kishte dhënë Eduard Kardeli - njeriu i dytë më i rëndësishëm në Jugosllavinë komuniste, pas Josip Broz Titos. Sipas tij, kombi është "bashkësi specifike njerëzore që ka lindur në bazë të ndarjes së punës në epokën e kapitalizmit, në kuadër të territorit, njëkohësisht gjuhës dhe të një kulture të përbashkët". "Ky është një nga definicionet më të mira për kombet që ka dhënë dikush ndonjëherë", thuhej dikur, nga ata që nuk i njihnin mirë definicionet e tjera, por që përsëritnin atë që "duhej" të thuhej, pasi ashtu e "kërkonte" puna dhe koha! Ishte propagandë. Apo, me termet e sotme: marketing për "prodhimin vendor"! Në anën tjetër, për Shqipërinë komuniste vlenë definicioni i Josif Stalinit për kombin, si "bashkësi stabile e njerëzve, e formuar në bazë të gjuhës së përbashkët, territorit, jetës ekonomike dhe veçorive psikologjike të manifestuara në kulturën e përbashkët".

## Bota "ekzotike" shqiptare

Njeriu lehtë mund ta ngatërrojë atë që ka thënë Kardeli me atë që thoshte Stalini. Në fakt, ka shumë definicione për kombin dhe që të gjitha ato ndërlikohen me gjuhën, territorin, historinë, etninë, veçoritë psikologjike dhe kulturën e përbashkët. Loja e fjalëve dhe autorësia kishin karakter poli-

tik, për ta mbrojtur interesin dhe ideologjinë e shtetit të caktuar. Për t'u veçuar nga të tjerët. Sepse, tekefundit, pjesëtari i një kombi nga shumica dikur njësohej me shtetin.

Por, kush është shqiptar sot? Cila është kultura e tij? Ku jeton ai? Dhe si veçohet ai?

Në faqen e saj në rrjetin social "Facebook", fotografja suedeze Ann Christine Eek shpeshherë publikon foto relativisht të vjetra bardhezi, nga rajoni i Deçanit. Shumica nga to janë bërë në vitet 1975-'76, gjatë vizitës që ajo dhe etnografja Berit Backer ia kishin bërë fshatit Isniq. Synimi ishte të vëzhgoheshin zakonet e familjeve shqiptare. Një pjesë e këtij vëzhgimi (studimi) është publikuar në veprën "Prapa mureve të gurit", që përqendrohet në evolucionin e familjes dhe të ekonomisë familjare të shqiptarëve të Kosovës, në një fazë të rëndësishme të transformimit të familjes tradicionale.

Në parathënien e këtij studimi, Robert Elsie ka cekur se si shqiptarët e Kosovës jetonin të izoluar dhe se si i rezistonin globalizimit në kohën e Jugosllavisë. Por, në mes të viteve '70 të shekullit XX, në kohën e shtimit të "gastarbajterëve" në Gjermani e në Zvicër, shqiptarët që punonin jashtë nisën të dërgojnë te familjet e tyre jo vetëm para, por edhe ide të reja. Mu për këtë, botimi i Backerit, me ilustrime të Eekut, për Elsie paraqiste një "pamje të mrekullueshme të një botë ekzotike e cila së shpejti do t'i përkasë së kaluarës, siç parashikoi autorja".

Backer dhe Eek takuan një botë "ekzotike" që nuk ekziston më, siç nuk ekziston ajo çfarë shihnin dikur në veriun e Shqipërisë studiuesit Edith Durham, çifti Rene Benezech dhe Jacqueline Benezech, Carleton Coon, Rose Wilder

Lane, Reimer Schulz, Hugo Adolf Bernatzik...

Tradita dhe mënyra origjinale e të jetuarit, familjet e mëdha dhe mënyra e organizimit të tyre, i zoti i shtëpisë, odat, mikpritja, pleqnarët, burrat, sakrifica e grave, përgatitja për luftë, për hakmarrje, fjala e mençur dhe besa që mbahej te shqiptari që nuk njihnte nocione për kombin, por që e dinte mirë se kush është e çka është gjaku... tash janë veç kujtim apo informatë për të shkuarën. Fatkeqësisht, për pakicën. Shumicën e ka pllakosur harresa. Ndaj, nga pjesët e përkufizimeve të mësipërme për kombin, vetëm gjuha - edhe ajo nëse trashëgohet nga prindërit - po e identifikon sot shqiptarin. Bashkësia, veçoritë psikologjike dhe kultura po bëhen çdoherë e më relative. Madje edhe territori! Gjithçka është virtuale! Gjithçka është versioni më i keq i Amerikës (Shteteve të Bashkuara të Amerikës)! Pse kështu?

## "Në Afrikë shkon babadimri, e para Parisit rri miki mausi"

Më 1990, rok grupi britanik Eurythmics realizon këngën "King and Queen of America" (Mbreti dhe Mbretëresha e Amerikës), që parodizonte me kulturën popullore amerikane. Siç ka thënë këngëtarja Annie Lenox, kjo është "këngë mllefi, që del nga irritimi për kultin e personalitetit. Në veçanti në Amerikë, aty ku njerëzit duan t'i ftojnë mediat në dhomat e tyre të ndejës dhe të flasin për jetët e tyre". Ndaj, mbret dhe mbretëreshë sot mund të jetë secili që mund t'i tërheqë masat, në çfarëdo mënyre.

Ishte ky viti 1990, kur komunizmit, Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik (BRSS) po u vinte fundi, si dhe koncepteve kardeliane e staliniste për kombin. Kombi dalëngadalë nisi të perceptohej si "komunitet magjinar" (Benedict Anderson) apo si "komunitet abstrakt" (Paul James). Disa të tjerë i ktheheshin definicionit të mëparshëm që Vance Packard dha për amerikanët - asaj që ai e quante "kombi i të huajve", meqë nga lëvizjet e shpeshta anëtarët e kombit po mbesin pa rrënjë, pa komunitet, anonimë, të izoluar e të huaj që

kurrë nuk do ta takojnë njëri-tjetrin.

Shkatërrimi i komunizmit ishte më i dukshëm kur amerikanët arritën ta fusin "Pepsi"-n në BRSS. Në vitin 1990, me marrëveshjen prej tre miliardë dollarëve mes dy armiqve më të mëdhenj të Luftës së Ftohtë, "Pepsistrojka" u bë rivali më i madh i Perestrojkës - reformave politike të Partisë Komuniste të BRSS-së të udhëhequra nga Mikhail Gorbachevi. Nga ky vit, produktet amerikane nisën t'i modelojnë kohët moderne. Amerikanizimi u bë fenomen global që akulturoi edhe shoqëritë më të izoluar. Ndaj, grupi gjerman Rammstein ironizon me këtë fenomen përmes këngës "Amerika": "Të gjithë jetojmë në Amerikë". Sepse, e gjithë bota po bëhet njëkombëshe - amerikane!?

"Në Afrikë shkon babadimri, e para Parisit rri miki mausi", është një pjesë tjetër e tekstit të grupit Rammstein, teksa në video, në duart e pjesëtarëve të fiseve tradicionale afrikane, shihen kutitë e picave të porositura me telefon; hamburgeri te murgjit budistë; atletet "Nike" në këmbët e besimtarit mysliman; stili i flokëve "Pompadour" - të afirmuara nga "Mbreti i mbretërve", imazhi i amerikanit Elvis Presley në kokën e të riut kinez; cigaret "Lucky Strike" te hindui me turban... Dhe ata këndojnë: "Të gjithë jetojmë në Amerikë"! E, shqiptari thotë: "Duaje atdheun, si shqiptarët Amerikën"! Por, cilin Atdhe dhe cilën Amerikë?

## Vdekja fatale e armikut!

Në fund të janarit të vitit 1991 nis Lufta e Parë e Gjirit Persik, gjatë së cilës 35 shtete, të udhëhequra nga ShBA-ja, për pak ditë përzunë forcat e Irakut që një vit më parë kishin invaduar Kuvajtin. Kjo luftë mbahet mend për transmetimet e para të drejtpërdrejta që rrjeti televiziv CNN i bënte nga fushëbetejat. E njëjta ndodhi edhe me puçin e gushtit 1991 në BRSS, të organizuar nga krahu radikal i Partisë Komuniste që kundërshtonte reformat e Gorbachevit, si dhe me lajmin për shpërbërjen e BRSS-së në dhjetor - superfuqisë së dytë botërore. Bota po ndryshonte dhe lajmet për këtë mëso-

heshin në kohë reale!

Me shkatërrimin e Bashkimit Sovjetik, Amerika mbeti superfuqia e vetme. Por, çdo e mirë vjen me obligime dhe sfida të reja. Drejtimi i të gjitha forcave të një armik mund të kthehet si bumerang pas fitores. Për ta kuptuar këtë vlen të citohej një fjali nga filmi "Conspiracy" (Komploti, 2001), që flet për Konferencën naziste të Vanzisë, për "Zgjidhjen përfundimtare të çështjes së hebrenjve". Aty një oficer gjerman thotë: "Një djalë urrente babanë e tij. E donte nënën. Nëna ishte e përkushtuar ndaj tij, por babai e rrihte, e përulte, s'e konsideronte të vetin. Sidoqoftë, ky djalë u rrit. Në të tridhjetat i vdes nëna, ajo nënë që e kishte ushqyer dhe mbrojtur. Ajo vdiq. Djali i rrinte afër teksa e ulnin arkivolin. Tentoi të qante, por lotët s'i dilnin. Babai i djalit jetoi gjatë. Kur vdiq, djali ishte në të pesëdhjetat. Në varrimin e babait, për habinë e tij, nuk mund t'i kontrollonte lotët. Vajtonte, dëneste nga të qarat. Dukej se ishte i pangushëllueshëm. I humbur madje. Djali tërë jetën e drejtoi në urrejtjen ndaj babait të tij. Kur nëna i vdiq, kjo ishte humbje. Kur babai i vdiq, kur urrejtja e kishte humbur objektin, atëherë jeta e tij ishte e zbrazët".

Meqë nuk ishte punë e lehtë të paramendohej një armik i ri i përmasave sovjetike, me CNN-in gjithçka u bë lojë, madje edhe lufta. Rreziqe të mëdha nuk kishte, e populli nuk mund të frikësohej më me kataklizmin nuklear. Ai duhej zbavitur e të mos lodhej me "tema të mëdha". Prandaj, në vitet '90 të shekullit XX kulmojnë televizionet e reja të realitetit dhe emisionet e debatit tabloid që punonin pa skenarë dhe që prezantonin jetët dhe përditshmërinë e të rëndomtëve. Në këto televizione nxitej injoranca, sepse kryesorja ishte zbavitja e masave - shumicës. Por, siç thotë filozofi anglez Roger Scruton, dëshirat e shumicës mund të jenë djallëzore dhe fuqia e shumicës mund të jetë e rrezikshme.

## "Profeti" i degjenerimit kulturor dhe koloseumi i turmave

Parashikimet për një realitet të tillë, ku lajm dhe vend qendror





nuk do të zë vlera e dija, janë dhënë më herët, që më 1985 nga kulturologu i madh amerikan Neil Postman, në veprën "Duke zbavitur veten për vdekje"! Në kohën kur u publikua vepra, president në Amerikë ishte një aktor, Ronald Reagan. Por, Postman në një mënyrë parashikoi edhe ardhjen në pushtet të Donald Trumpit - njeriut të produktit televiziv, fenomenit që urrente. Sepse, nëse politika perceptohet si shoubiznes, atëherë "ideja nuk është ta synosh përsosmërinë, të qartën apo ndershmërinë", por të shtiresh për to. Kryesorja është ta reklamosh veten! E, sipas Postmanit, "ajo që reklamuesi duhet të dijë nuk është çka është në rregull me produktin, por çka nuk është në rregull me blerësin". Televizioni pra u bë Koloseumi i ri. Ky model është aplikuar ndër shekuj, që nga Perandoria Romake e cila ndërtoi një amfiteatër gjigant - për t'i mbushur arkat e perandorit me paratë e masave, e për t'i larguar po këto masa nga "temat e mëdha" duke i zbavitur ato. Por, ajo që ofrohej brenda mureve të Koloseumit ishte degjenerim moral dhe kulturor. Sipas historianit Cameron Hawkins, brenda vitit aty mund të jenë vlarë mbi pesë mijë gladiatorë (pothuaj 14 çdo ditë). Dhe, ky krim zgjati gati 400 vjet, derisa nuk u kalb dhe nuk u shua nga brenda Perandoria Romake. Shembull për këtë është edhe Jugosllavia komuniste. Në prag të tronditjeve të mëdha politike, aty triumfon mediokriteti. Kështu, më 1989, në garat e Jugosllavisë për Evropizion, vendin e parë e zë një grup i parëndësishëm i quajtur Riva, me këngën e dobët "Rock Me Baby". Çuditërisht, me këtë

këngë të dobët që kishte përmbajtje "eskapist" për një vend që gufonte nga nacionalizmi, Jugosllavia për herë të parë fitoi në Evropizion. Ndërkaq, në festivalin Akordet e Kosovës, duke ndjekur këtë trend të çoroditur, "Okarinën e Artë" më 1989 - vit ky i suprimimit të autonomisë së Kosovës dhe i rritjes së rezistencës popullore kundër politikave të Sllobodan Millosheviqit - e fiton "Rock Me Baby Kosovare", një këngë infantile, me muzikë, tekst, aranzhman e interpretim të keq nga katër tinejxherë që, gjoja, ishin (Irida). Në të dy rastet, realizimi i qëllimeve politike synohej me degradimin e kulturës përmes garave më të rëndësishme e me më së shumti shikueshmëri. Sepse, përmes tjetërsimit kulturor, triumfit të antivlerave që nxisin ambiciet për famë nga secili, popujt nuk e njohin realitetin, frenohen e mbahen më lehtë nën kontroll. Ai tjetërsim kulturor që nisi më 1989 e që do të kulmojë me mbylljen e shkollave dhe institucioneve kulturore në dy vjetët në vijim, e mban peng edhe sot Kosovën, siç e mban peng Shqipërinë hapja e egër ndaj Perëndimit, ku qëllim kryesor i shumicës ishte pasurimi me çdo kusht e jo zhvillimi dhe humanizimi i shtetit.

### Liria si diktaturë

Tjetërsimi kulturor ka bërë që gjithçka në Kosovë, në Shqipëri e në Maqedoni mund të quhet art, e se kushdo mund të bëhet i famshëm. Në El Doradon e mediokritetit, çdo injorant mund të ketë pushtet, e pushtetin ta ketë "punën" e parë me rrogë! Madje, do të cilësohet i mençur e do t'i besohet fati i vendit e i popullit. Masat nuk do

të luftojnë për të vërtetën, aq më pak të kërkojnë llogari sepse, siç ka thënë Postman që më 1985 - kohë kjo kur nuk kishte portale të lajmeve e as rrjete virtuale sociale - ata janë të dhënë pas teknologjive që i zhbëjnë kapacitetet e të menduarit. Ndaj, "nuk flasim më me njëri-tjetrin; ata zbavitin njëri-tjetrin. Nuk shkëmbejnë ide; ata shkëmbejnë imazhe. Nuk debatojnë me propozime; ata debatojnë me dukje të mirë, me famë dhe reklama".

Në këtë realitet të ri kemi një përmbajtje të mendimeve e bindjeve të mëparshme për vlerat. Kështu, nëse dikur kishte ndarje strikte klasore në mes të shtresave të pasura e të varfra, sot ato bashkohen nga mediokriteti; nëse dikur kishte ndarje mes atyre me shkollim të duhur dhe atyre pa shkollim, sot është një thes për të gjithë; nëse dikur dikush identifikohet për qëndrim të denjë intelektual dhe moral, për sakrificën për një kauzë, sot kushdo mund të thirret veç me fjalë në kauza e të quhet idealist; nëse dikur dikush zinte vend në media për dije dhe vlera, sot ka hapësirë më të madhe për ata me mungesë të dije dhe të vlerave; nëse dikur gabimi nuk falej lehtë, sot gabimi harrohet shpejt; nëse dikur duhej shumë mund për t'u bërë lider, sot mjafton të jetë aktor i mirë... sepse gjithçka është lojë! Këtë kaos që po e imponon shoqëria e shoubizit, e trajton filmi "God Bless America" (Zoti e bekoftë Amerikën!, 2011), ku për të qenë normal në shoqëri abnormale duhet të jesh si masat - të merresh me thashetheme, me kauza të rrejshme, me trivialitete... ndryshe do të jesh i huaj, "prapanik" e i vetmuar. Diçka të ngjashme trajton filmi iranian "Lerd" (Njeriu i integritetit, 2017), që flet për

korruptionin në shoqërinë iraniane (siç është shoqëria shqiptare, kudo), realitet ky i hidhur ku nuk ka rrugë të mesme, veç dy mundësi jetësore: të jesh i shtypur ose shtypës. Në të dyja rrethanat njeriu nuk është i lirë: ofhtë në diktaturë, apo në shoqëritë e shoubizit ku robëria vjen nga keqkuptimi i konceptit të lirisë - sidomos i lirisë së të shprehurit. Në të dy rastet e pëson i ndershmë dhe i dituri: në diktaturë mund të arrestohet e të heshtet zëri i tij, në shoqërinë e shoubizit e të debatit veçse është i heshur meqë nuk përfilllet. Për t'u ruajtur kjo gjendje, populli vazhdimisht duhet të bombardohet me lajme të ngurta që nuk nxisin veprime; me debate shterpe që nuk ofrojnë zgjidhje; me lafe për ata që interpretojnë dhe komentojnë ngjarjet e jo për shkaktarët e fenomeneve; me debate për debatet... Kjo anë e errët e Amerikës është gjuha (zbavitja), territori (lajmi), etnia (trivialiteti), psikologjia (injanca), historia (harresa) dhe kultura (shoubizi) e sotme e shqiptarit. Ky është sot definicioni i kombit... shqiptar!

### Megjithatë, Amerika është larg

Aktori nga Anglia, Sacha Baron Cohen, i njohur për portretizimin - në situata reale - të karaktereve të çuditshme fiktive, po e zbërthen së voni këtë anë të errët të Amerikës, në serinë televizive "Who Is America" (Kush është Amerika?). Përmes pesë karaktereve të reja dhe intervistave me emra të njohur - në mesin e të cilëve edhe Dick Cheney, nënkryetari më i fuqishëm në historinë amerikane, për çka për të u bë filmi "Vice" (Nënkryetari, 2018) - ajo që prezantohet nga bota e

artit modern, politikës dhe shoubizit, është mjerim. Më i mjerë është edhe votuesi i cili jeton duke mbrojtur kauza të rrejshme nacionaliste nga frika se kërcënohet vazhdimisht nga armiqtë e jashtëm.

Scruton thotë se nacionalizmi zë hapësirën e lënë bosh nga religjioni. Ndërkaq, Harley Austin thotë se derisa nacionalistët adhurojnë qeverinë, zakonisht të llojit tiranik që e rrënon në mënyrë aktive vendin e tyre, patriotët janë diçka tjetër sepse e trajtojnë vendin me respekt dhe janë të gatshëm të luftojnë kundër një qeverie tiranike që kërcënon të drejtat e tyre.

Në Kosovë, në Shqipëri e në Maqedoni nacionalistët me kauza të njëjta po mbijetojnë për mbi dy dekada. Në ShBA ata shpejt harrohen. Sepse, e keqja është pjesë e lajmeve, lajmet janë për t'u harruar e me to edhe njerëzit. Kështu citohet në filmin "Game Change" (Efekti Sara Palin, 2012), të ketë thënë truri i kampanjës së John McCainit për zgjedhjet presidenciale të vitit 2008, Steve Schmidt, i cili, duke menduar se Amerika ka nevojë për aktor, zgjedh një injorante si Sarah Palin të jetë kandidatë për nënkryetare. Karriera e Palinit me nominimin e vitit 2008 e mbërriti kulmin. Shans tjetër të madh për të nuk kishte, sepse këtë nuk e lejon ana tjetër e Amerikës: ana patriotike që i mungon shqiptarit e që e bën Amerikën të ketë katër universitete në katër vendet e para të listës së institucioneve më të mëdha të dijes në botë; të ketë 375 fitues të Çmimit Nobel; të ketë ekonominë më të fortë në botë; të jetë vendi më i fuqishëm; vendi që prin në inovacione; tokë e ëndrrave dhe e mundësive... Te këto vlera nuk ka lojë, nuk ka zbavitje. Njerëzit që i bartin ato mbrohen, çmohen dhe kanë zë - madje të fuqishëm.

Këtë anë të Amerikës nuk e duan pushtetarët shqiptarë, sepse kjo rrezikon mbijetesën e tyre dhe të secilit që ka mbijeturar dhe përfituar falë kaosit të vlerave.

Megjithatë, çdo lojë ka një fund. Asgjë nuk është e përjetshme. Këtë e thonë edhe profecitë shqiptare. Këtë e ka thënë latinët (Verba volant, scripta manent) dhe "profeti" i degjenerimit kulturor. "Fjala e shkruar reziston, fjala e folur zhduket. Kjo është arsyeja pse shkrimi është më afër të vërtetës se e folura", ka thënë Postman. Prandaj, proklamuesit e anës së errët të Amerikës ndër shqiptarë, ata që janë të pushtuar nga mania e famës dhe e pushtetit, do të bien pre e trinitetit të tyre për mbijetesë: zbavitje, trivialitet dhe... harresë!

(Marrë nga numri i pestë i revistës "Akademia")





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije  
Ministri of Education, Science and Technology

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligji Nr.03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, *Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë* bën:

**Shpallje të konkursit për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"**

Institucioni: *Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë*

Departamenti: Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm: Divizioni për njohje /barasvlere dhe informim akademik (NARIC)  
Paga bruto: 423.85 €

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e administrativ në divizionin për njohje/ barasvlere dhe informim akademik (1 vend pune)

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj

Vendi i punës: Prishtinë Datë: 24.07.2019

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

1. Punë me palë;
2. Arkivon dhe sistemon dosjet që përfundojnë procedurën për nostrifikim;
3. Informon palët për tërheqje të vendimeve;
4. Mban procesverbal dhe përgatit procesverbalin e KSHNJ dhe të tjera;
5. Si dhe punë të tjera sipas nevojës së Qendrës NARIC

**Kualifikimet**

1. Diplomë universitare;
2. Njohuri dhe përvojë në çështje administrative
3. Shkathtësi të komunikimit me palë;
4. Aftësi për pëmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
5. Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, PowerPoint, Access, Internetit).
6. Preferohet njohja e gjuhës angleze.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Data e mbylljes së konkursit:** Konkursi mbetet i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në ueb faqen e MASHT-it dhe shtypin ditor. Data e mbylljes së konkursit 29.07.2019.

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në ueb faqen e MASHT-it <http://masht.rks-gov.net/>, ose ta marrin në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Adresa: Rr. "Agim Ramadani" nr. 1, në zyrën e arkivit ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar.

**Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten:** Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije  
Ministri of Education, Science and Technology

U skladu sa odredbama Zakona o civilnoj službi Republike Kosova Zakona br. 03/ L - 149, član 12, stav 4, *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije*:

**Objavljuje konkurs za "Sporazum o posebnim uslugama "**

Institucija: *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije*

Departament: Kancelarija generalnog sekretara: Divizija za priznavanje /ekvivalenciju i akademska informisanja (NARIC).  
Bruto plata: 423.85 €

Naziv radnog mesta: Administrativni/a službenik/ca u Diviziji za priznavanje/ekvivalenciju i akademska informisanja (1 radno mesto)

Trajanje ugovora: 6 meseci

Radno mesto: Priština Datum: 24.07.2019

**Zadaci i odgovornosti:**

1. Rad sa strankama;
2. Arhivira i sistematizuje dosije koje završe proceduru nostrifikacije;
3. Obaveštava stranke o podizanju odluka;
4. Vodi zapisnik i priprema zapisnik DSPi drugo;
5. Kao i druge poslove shodno potrebama Centra NARIC

**Kvalifikacije**

1. Univerzitetska diploma;
2. Znanje i iskustvo u vezi administrativnih poslova
3. Veštine u komunikaciji sa strankama;
4. Sposobnosti u ispunjavanju obaveza i poslova pod pritiskom;
5. Kompjuterske veštine aplikacije programa (Word, Excel, PowerPoint, Access, Internet);
6. Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

**Uslovi učešća na konkurs:**

Pravo na aplikaciju imaju svi punoletni građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost delovanja, potrebni nivo obrazovanja i profesionalne veštine za obavljanje zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

**Datum zatvaranje konkursa:** Konkurs ostaje otvoren 5 kalendarska dana od dana objavljivanja na web stranici MONT-a i dnevnim novinama. Datum zatvaranje konkursa je. 29.07.2019

Kandidati aplikaciju (formular za konkurisanje) mogu preuzeti na web stranici MONT-a <http://masht.rks-gov.net/>, ili da podignu u Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije, Adresa: Ul. "Agim Ramadani" br. 1, u kancelariji arhive u kojoj će i dostaviti popunjene aplikacije.

**Aplikaciji treba priložiti:** Kopiju lične karte, kopiju dokumenta o kvalifikaciju, kao i drugu dokumenta koja se zahtevaju konkursom.

Zahtevi poslati nakon isteka datuma neće se primati. Zbog velikog broja primljenih zahteva, kontaktirani će biti samo kandidati koji budu izabrani na užoj listi.





# Ky ishull në Greqi u jep shtëpi dhe 500 euro në muaj

Nëse keni ëndërruar gjithmonë të largoheni nga shtëpia dhe të jetoni në një parajsë tokësore, atëherë ka ardhur shansi juaj: një ishull idilik grek po kërkon banorë.

Ishulli grek i Cerigotto ose (Antikythera) është njëzet kilometra katrorë, pothuajse tërësisht i paprishur, me ujëra të smeraldta dhe një fshat të vetëm, Potamos, i cili gjithashtu shërben si port kryesor dhe pika e mbërritjes në ishull.

Ky ishull është gjithashtu vendi ku u zbulua një nga kompjuterët më të vjetër mekanike të gjetur ndonjëherë, Makina Anti-Taunt, e ndërtuar rreth viteve 150-100 para Krishtit, mekanizmi i pajisjes së të cilit përdoret për të parashikuar pozicione astronomike, eklipset, orbitat dhe madje shënojnë periudhën katërvjeçare ndërmjet secilës Olimpiadë.

Për fat të keq, Antikythera i ka humbur banorët dhe vetëm rreth dyzet vetë jetojnë aktualisht në ishull. Për këtë arsye, me ndihmën e Kishës Ortodokse, filloi një fushatë ripopullimi, për të gjetur familje të reja, të gatshme për të lëvizur në këtë ishull të vogël, por të bukur.

Procesi i përzgjedhjes është i kujdesshëm dhe i jep përparësi popullit grek, por kushdo që zgjidhet i jepet një shtëpi, një pjesë toke për të filluar një aktivitet bujqësor ose për të ndërtuar një biznes dhe një pagesë mujore prej 500 euro për të paktën tre vjet qëndrimi. Jo keq, duke pasur parasysh se është gjithashtu një vend i bukur.

Nëse dëshironi të jetoni në paqen dhe qetësinë e një ishulli parajsor, atëherë Antikythera është vendi për ju. Ishulli është dy orë me traget nga Kreta.





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Gashi: Sportistët kulminante do ta kenë përkrahjen e shtetit

Ekipi i xhudos është shpërblyer me 150 mijë euro nga MKRS-ja për sukseset e arritura në Lojërat Evropiane. Majlinda e fitoi të artën në Minsk të Bjellorusisë, kurse Nora e fitoi të argjendtë dhe Loriana të bronzit. "Xhudistët janë vërtet krenaria jo vetëm e jona si Ministri por edhe e Republikës së Kosovës dhe e të gjithë qytetarëve të saj", ka thënë ministri Gashi

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 KORRIK - Tri xhudistet e Kosovës, Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Loriana Kuka dhe trajneri Driton Kuka janë shpërblyer të premtën nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për sukseset e arritura në Lojërat Evropiane që janë mbajtur nga 21 deri më 30 qershor në Minsk të Bjellorusisë. Në bazë të Rregullores për ndarjen e shpërblimeve shtetërore për sportistët që arrijnë rezultate kulmore në garat ndërkombëtare, ministri Kujtim Gashi shpërblimin prej 50 mijë euro, Majlinda Kelmendi, e cila në këto lojëra arriti të fitoi medaljen e artë. 30 mijë euro i takuan xhudistes, Nora Gjakova e cila u stoliste me medaljen e argjendtë. Ndërsa Loriana Kuka që e fitoi medaljen e bronzit u shpërblye me 20 mijë euro. 50 mijë euro i kanë takuar edhe trajnerit, Driton Kuka, i cili është më mirëtor për sukseset e ekipit të xhudos në gara ndërkombëtare. Ministri Gashi ka konfirmuar se MKRS-ja do të vazhdon të jetë në mbështetje të xhudistëve dhe sportistëve tjerë që i sjellin suksese Kosovës nga arena ndërkombëtare. "Ministria do të vazhdojë të jetë në mbështetje dhe përkrahje tuajën, jo vetëm për xhudos por për të gjitha disiplinat sportive dhe në mbështetje të vazhdueshme edhe për Federatën. Është e përkushtuar jashtëzakonisht që t'i mbështesë sportistë tanë që në vazhdimësi po i sjellin rezultate kulminante vendit tonë. Xhudistët janë vërtet krenaria jo vetëm e jona si Ministri por edhe e Republikës së Kosovës dhe e të gjithë qytetarëve të saj", ka thënë ministri Gashi. Në anën tjetër xhudistja Majlinda



Kelmendi që vazhdon të jetë sportistja më e suksesshme në Kosovë, e ka falënderuar Ministrinë e Sportit për mbështetjen e dhënë. "Është një mbështetje jashtëzakonisht e madhe nga ana e Ministrisë e kjo mbështetje është edhe një motiv për të punuar edhe më shumë në të ardhmen", ka deklaruar Kelmendi. Ministrin Gashi e falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme edhe trajneri Driton Kuka.

## Kuka: Synojmë medalje në 'Tokyo 2020'

Trajneri Driton Kuka pas pranimit të shpërblimeve nga MKRS-ja, ka thënë se

ministri Kujtim Gashi, ka bërë një punë të madhe prej se e ka marrë detyrën e ministrit të sportit. Më këtë rast, Kuka ka paralajmëruar se synim i xhudistëve janë medaljet në "Tokyo 2020". "Majlinda, Nora e Loriana protagonistet e medaljeve në Minsk bashkë me mua si trajner morëm shpërblimet shtetërore nga ministri Kujtim Gashi. Ministrin i shpreha mirënjohjen për angazhimin e tij permanent prej se ka ardhur në detyrë. Drejtë Lojërave Olimpikë po hapërojmë me 5 garuesit tonë që për momentin janë me normë Olimpikë duke pretenduar që edhe nga "Tokyo 2020" të kthehem me medalje", ka shkruar Kuka në "Facebook".

## SHKURT

### KON-i fton Kosovën për pjesëmarrje në Olimpiadën 'Tokyo 2020'

Komiteti Olimpik i Kosovës të premtën ka pranuar ftesën e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC) për pjesëmarrje në Lojërat Olimpikë "Tokyo 2020". Për Kosovën, "Tokyo 2020" do të jenë lojërat e dyta olimpikë në të cilat, po ashtu, synon medaljen. Në "Rio 2016", ekipi i Kosovës debutoi me medaljen e arit të fituar nga kampionia dhe heroina jonë, Majlinda Kelmendi.

### Balaj prezantohet te Strum Graz

Bekim Balaj është zyrtarisht lojtar i Strum Grazit, skuadër që militon në elitën e futbollit austriak. Sulmuesi i kombëtares shqiptare firmosi kontratë dyvjeçare, me opsion zgjatjen edhe për një vit tjetër. Kujtojmë që 28-vjeçari shkodran në tre vjetët e fundit ka luajtur në Rusi, me skuadrën e Akhmat Grozny, teksa sezonin e fundit vuajti nga dëmtimet dhe arriti të shënjojë vetëm tre gola. "Sturm Graz është një klub tradicional me tifozë të mëdhenj. Mua më pëlqen. Tani është e rëndësishme të integrohem sa më shpejt që të jetë e mundur për ta ndihmuar ekipin", ka thënë Balaj.

### Notarët përfundojnë garat në 'Baku 2019'

Hana Fejzullahu ishte notarja e fundit që garoi në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj, "Baku 2019". Ajo garoi sot në 800 metra stil i lirë dhe pati kohën 10.20.03, që nuk i mjaftoi për t'u kualifikuar tutje. Të premtën garuan edhe Jona Macula dhe Elona Zhugolli në 50 metra stil i lirë, të cilat përmirësuan rekordet e tyre personale. Sporti i notit në "Baku 2019" u përfaqësua edhe me notarët Olt Kondirolli dhe Vigan Bytyqi.

## Progni lë Teutën për Gjilanin

GJILAN, 26 KORRIK - Gerhard Progni është larguar nga skuadra e Teutës për ta vazhduar karrierën në Superligën e Kosovës, përkatësisht në skuadrën e Gjilanit. Ka qenë Klubi i Gjilanit që e ka zyrtarizuar transferimin e 32-vjeçarit, i cili në të kaluarën ka luajtur edhe për Partizanin,

Besën, Dinamon, Flamurtarin dhe Skënderbeun. "SC Gjilani ju njofton se ka arritur marrëveshje me mesfushorin e krahut të djathtë, Gerhard Progni", thuhet në njoftimin e Gjilanit.

Progni gjithashtu karrierë kishte bërë edhe jashtë Shqipërisë, që për disa muaj ai

kishte mbrojtur ngjyrat e ekipit nga Superliga e Azerbajxhanit, FC Zira. Futbollisti më i ri i Gjilanit, Gerhard Progni, gjithashtu ishte pjesë e rëndësishme e shpresave të Shqipërisë, me të cilët kishte bërë mbi 10 paraqitje, duke realizuar edhe dy gola në fanellën e kuqezinjve.





## Kosova U18 mposhtet nga Hungaria

**BUKURESHT, 26 KORRIK** - Përfaqësuesja e Kosovës U18 e meshkujve ka zhvilluar ndeshjen e parë në Kampionatin Evropian, Divizioni B që po

mbahet në Rumani. "Dardanët" e rinj kanë pësuar humbje në takimin e parë nga Hungaria me rezultat 55-78, edhe pse patën paraqitje mjaft

të mirë dhe në shumë minuta kanë qenë të barabartë me kundërshtarin. Erhan Sholla u dallua te Kosova me 18 pikë, derisa Albin Berisha shënoi

11. Sidoqoftë, ky evropian do t'i ndihmojë Kosovës të fitojë më shumë përvojë. Sfidat e radhës është të shtunën nga ora 15:15 kundër Suedisë.



## Rugova: Me ndihmën e tifozëve mund të kualifikohemi



**PRISHTINË, 26 KORRIK** - Basketbollistët e Kosovës janë duke stërvitur intensivisht për ndeshjet parakualifikuese për "Eurobasket 2021". Ekipit i janë bashkuar edhe Dardan Kapiti, Meriton Ismaili dhe Atik Koshi, që ishin me Kosovën U20 në Evropianin në Portugali, Divizioni B. "Dardanët" janë në grup me Luksemburgun dhe Britaninë e

Madhe, ku fituesi i grupit kualifikohet tutje. "Britania është favoritja e grupit, por mendoj se Luksemburgu ka një ekip shumë të mirë. Nuk bën të nënçmohet. Secila ka gjasat e saj. Ne do të luajmë për fitore në çdo ndeshje. Kemi përparësinë se ndeshja e dyta dhe e tretë zhvillohen në shtëpinë tonë. Sfidat e parë është shumë e rëndësishme dhe do të mendohe-

mi të fitojmë, e pastaj e presim Britaninë në betejën e madhe", ka thënë Rugova. Ai foli edhe për rëndësinë që ka publiku për takimet në shtëpi. "Kemi luajtur edhe më herët në Mitrovicë dhe atmosfera ka qenë e jashtëzakonshme. Besoj se kështu do të jetë edhe kësaj radhe. Shpresoj shumë në ndihmën e tyre dhe të kualifikohemi tutje", ka shtuar Rugova.

## Williamsi: Nuk dua ta barazoj rekordin, por ta thyjej atë



**SAGINAW, 26 KORRIK** - Tenistja amerikane Serena Williams, fituese e 23 grand slamve në karrierën e saj, është një trofe larg rekordit të Margaret Court. Një rekord që duket një tabu për tenisten 37-vjeçare, që pas shtatzënisë ka humbur 3 finale radhazi (2 herë në Wimbledon dhe një herë në US Open). "Duhet t'i marr gjërat me

qetësi, sidomos në nale. Unë jam e kënaqur me ecurinë dhe po arrij rezultate të mira për moshën time. 23 tore në grand slam nuk janë pak, por kam mundësi për më shumë. Problem është ta barazoj rekordin, pasi atëherë do të vijë edhe trofeu tjetër, duke vendosur rekordin e ri", ka thënë Serena Williams. Amerikania po përgatitet për grand

slamin e shtëpisë, atë të US Open, që nis në fund të gushtit. Ndërkohë që, pritet të marrë pjesë në dy turnetë Masters që zhvillohen në Montreal e Sinsinati tri javët në vijim. "Çdo gjë me radhë. Mezi pres të arrij te trofeu, por duhet të qëndroj me këmbë në tokë dhe përgatitem mirë nga ndeshja në ndeshje", ka deklaruar Williamsi.

### SHKURT

#### Fiorentina dhe Arsenali në garë për Khediran

Mediet italiane raportojnë se Fiorentina u ka kërkuar informacione Juventusit për Sami Khediran. 32-vjeçari, i cili është pjesë e bardhezinjve që nga viti 2015, kur u transferua nga Real Madridi, pritet të largohet nga "Zonja e Vjetër" gjatë kësaj vere. Futbollisti nuk bën pjesë në planet e trajnerit Sarri derisa, përveç skuadrës italiane të Fiorentinës, interesim për shërbimet e tij ka treguar edhe Arsenali.

#### Napoli i shtohet garës për Pepen

Skuadra e Napolit është futur në garë për transferimin e Nicolas Pepe nga Lille. Në garë për futbollistin Pepe janë edhe Manchester Unitedi, Liverpooli dhe Bayern Muncheni, kurse skuadra italiane ka bërë gati një ofertë prej 80 milionë eurosh.

#### Evertoni e kërkon Zahan

Evertoni është skuadra e tretë në Premierë Ligë që ka shfaqur interesim për transferimin e yllit të Crystal Palaces, Wilfried Zaha. "Sky Sports" raporton se Evertoni është i gatshëm të paguajë 60 milionë funte për Zahan, i cili kërkohet edhe nga Arsenali dhe Chelsea.

#### Barça nuk llogarit në Rakitiqin dhe De Jongun

Barcelona, pas transferimit të Frenkie De Jong nga Ajaxi, po mendon të dy mesfushorë. Fjala është për Ivan Rakitiqin dhe Arturo Vidalin, pasi ata nuk bëjnë pjesë në planet e trajnerit Ernesto Valverde. Më herët ishte skuadra e Interit që kishte shfaqur interesim për këta futbollistë.

#### Roma, 30 milionë dhe Dzekon për Icardin

AS Roma ka ofruar 30 milionë euro dhe Edin Dzekon për ta bindur Interin që ta shesë sulmuesin Mauro Icardin. "Giallorossët" janë të gatshëm t'i propozojnë sulmuesit argjentinas një pagë prej pesë milionë eurosh neto, por kjo duket të jetë e ulët pasi lojtari fiton afërsisht kaq tek Interi. Oferta e Romës është e vështirë për t'u pranuar, pasi Interi dëshiron 80 milionë euro për Icardin.

#### Atletja holandeze arrestohet me 50 kg drogë në makinë

Atletja holandeze Madiea Ghafoor është arrestuar nga policia në kufirin gjerman, pasi në makinën e saj u gjetën 50 kilogramë drogë të llojit metamfetamin dhe ekstazë, me vlerë 2 milionë euro. 26-vjeçarja ka qenë në Dusseldorf të Gjermanisë duke kryer një seancë stërvitore dhe më pas është arrestuar në një kontroll rutinë, edhe pse ajo e ka mohuar se kishte substanca të ndaluara në makinë. Ghafoor është arrestuar më 18 korrik, por vetëm para një jave kanë dalë detaje nga një operacion anti-drogë dhe policia gjermane konfirmoi arrestimin e saj. Ajo ka marrë pjesë nën flamurin e Holandës në "Rio 2016" në stafetën 4x400 metra, së bashku me koleget e saj. Federata e Atletikës në Holandë janë shprehur të shokuar nga ky lajm dhe nëse akuzat vërtetohen, atëherë karriera e sportistit ka marrë fund.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës  
Agencija sa Upravljanje Memorialni Kompleksa Kosova  
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

Form. MAP- SHCK-02  
Obraz. MJU-CSK-02



### SHPALJE E REKRUTIMIT / OGLAS ZA REGRUTACIJU

Institucioni/Institucija: AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS (AMKMK), kërkon të punësojë në AMKMK: / AGENCIJA SA UPRAVLANJE MEMORIALNI KOMPLEKSA KOSOVA-(AUMKK) nastoji da zaposli u AUMKK:

Titulli i vendit të punës / Naziv radnog mesta:

- Zyrtar i Lartë për Teknologji Informativ - TIK/560 / JP00040032 (1 pozitë)
- Viši službenik za Informacionu Tehnologiju-TIK/560/ JP00040032 (1 položaj)

Departamenti/Divizioni:

- Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme/Divizioni për TI, GIS Shërbime Logjistike
- Odeljenje za Financije i Opste Usluge/ Divizija za IT, GIS, logističke usluge

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës/Funksionalna kategorija i stepen radnog mesta:

- Niveli profesional, koeficienti i pagës 8 / Struka Profesionalna, -koeficijent plate 8

Vendndodhja e pozitës: Prishtinë/Priština

Numri i referencës së vendit të punës/ Broj preporuke za radno mesto: RN00005294

Detyrat dhe përgjegjësitë / Poslovi i odgovornosti:

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën Teknologjisë Informativë dhe shërbimeve logjistike 20%
- Kryen detyra e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara; 15%
- Bën hulumtime, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandime për shqyrtim nga nivelet e larta rreth detyrave ose projekteve të specializuara të miratuara në fushën Teknologjisë Informativë dhe shërbimeve logjistike 15%
- Udhëhoq grupet punuese në fushën përkatëse, kur kërkohet një gjë e tillë; 15%
- Ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda njësisë organizative për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre; 10%
- Ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda institucionit; 10%
- Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës, me autoritetet e jashtme; 10%
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;

- Razvija i odobrava planove rada i rokove, u koordinaciji sa supervizorom, za realizaciju projekata, usluga i srodnih proizvoda u oblasti informacionih tehnologija i logističkih usluga 20%
- Sprovesti zadatke predviđene planovima rada usvojenim u skladu sa zakonima, propisima, politikama i procedurama o kojima je reč, u predviđenim rokovima; 15%
- Izvršava istraživanje, analizu, procenu opcija i preporuka za visok nivo pregleda specijalizovanih zadataka ili projekata usvojenih u oblasti usluga informacionih tehnologija i logistike 15%
- Vodi radne grupe u relevantnoj oblasti, kada je to potrebno;
- Obezbediti savete osoblju nižeg nivoa u okviru organizacione jedinice za izvršavanje njihovih dužnosti i odgovornosti; 10%
- Pružanje savjeta u oblasti stručnosti koja je potrebna u instituciji; 10%
- Koordinira rad sa drugim dijelovima institucije i komunicira, prema potrebi, sa vanjskim vlastima; 10%
- Obavlja sve druge dužnosti u određenom profesionalnom polju u skladu sa važećim zakonima i propisima koji se mogu razumno zahtijevati s vremena na vrijeme; 5%

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim / Uslovi za učešće na regrutaciji/

- Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë të veprojne, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative, si dhe kanë aftësitë fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse. /

- U Civilnoj službi ima pravo zaposlenja državljani Republike Kosovo punoletni koji imaju punu sposobnost obavljanja poslova, koji su u posedovanju civilnih i političkih prava, koji imaju potrebnu školsku spremu i stručnu sposobnost za obavljanje zadataka u ekzekutivu, upravljanju ili sprovođenju administrativnih funkcija, oni koji imaju psiho-fizičku sposobnost koja su potrebna za obavljanje dotičnih zadataka.

- Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës mund të bëhet deri në një (1) vit para moshës së pensionimit. /
- Prijem u Civilnoj službi Kosova može se izvršiti do jedne (1) godine pre penzionisanja.

Procedurat e konkurrimit / Postupak konkurisanja/

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët të jashtëm dhe për nëpunës civilë ekzistues / Procedura konkurisanja je otvorena za spoljne kandidate kao i za postojeće civilne službenike

Shkollimi i kërkuar / Obrazovanje koji se zahteva/

- Diplomë universitare, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Shkenca Kompjuterike;
- Univerzitetska diploma, Fakultet Elektrotehnikë i Računarstva, Kompjuterske Nauke;

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen / Veštine, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju.

- Minimum tri (3) vite përvojë pune profesionale.
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

- Minimalno tri (3) godine profesionalnog iskustva;
- Duboko i specijalizovano znanje iz specifične stručne oblasti stečene univerzitetskim obrazovanjem i odgovarajućom obukom;
- Poznavanje važećih zakona i propisa;
- Veštine u radu na planiranju komunikacije i vođenju tima;
- Istraživačke, analitičke, veštine ocenjivanja i formulisanje preporuka i profesionalnih saveta;
- Kompjuterske veštine u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Pover Point, Access);

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin / Zakonski i podzakonski akti koji regulišu zapošljavanje: Përzgjedhja bëhet në pajtim me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil. / Izbor se vrši u skladu sa Zakonom br.03/L-149 o Civilne Službe Republike Kosova, Pravilnika br.02/2010 o procedurama regrutacije u Civilnoj Službi.

Kohëzgjatja e emërimit / Vremenski rok imenovanja: Me afat të pacaktuar - e përhershme (e karricës) / Na neodređeno vreme - stalna (karijere)

Afati i konkursit / rok konkursa Afati i konkursit është 15 ditë kalendrike, nga data e publikimit në mjetet e informimit publik / Rok za konkurs je 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja u javnim infomrativnim sredstvima.

Data e mbylljes së konkursit / Krajni rok konkursa: 10 gusht/avgust 2019

Paraqitja e kërkesave / Prijava zahteva-Podnošenje zahtevi/

Aplikacionet merren dhe dorëzohen / Aplikacija se uzima i dostavlja:

Rr. "Zenel Salihu", objekti i ish-Gjykatës Themelore të Prishtinës, kati i II-të, zyra nr. 204, Divizioni për Burime Njerëzore, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale ose mund të shkarkohen në ueb-faqen <https://amkmk.rks-gov.net>, Ul. "Zenel Salihu", bivša zgrada Osnovnog Suda u Pristini, sprat II, kancelarija br.204, Odsek za Ljudske Resurse, Agencija sa Upravljanje Memorialni Kompleksa Kosova ili se može preuzeti sa ueb-stranice <https://amkmk.rks-gov.net>

Kërkesat specifike / Specifični zahtevi: Nuk ka/Ne

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit:

- Dëshminë e kualifikimit shkollor (diplomat jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i);
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Dy rekomandime (nëse kenë);
- Kopjet e dy raporteve të fundit, të njëpasnjëshme, të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
- Dokumenti i identifikimit;

Uz Zahtev (Aplikaciju) treba dostaviti kopiju dokumenata:

- Dokaz o obrazovnim kvalifikacijama (diplome stečene u inostranstvu moraju se proveriti u MPNT);
- Dokaz o random iskustvu;
- Dve - Preporuke (ukoliko ih imate);
- Kopija dve zadnje uzastopne procene posla (ako ista postoje);
- Dokument identifikacije;

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe asaj femërore, nga të gjitha komunitetet në Kosovë" / "Kosovska javnana služba je u službi svih ljudi na Kosovu, i prima aplikacije muškaraca i žena iz svih Kosovskih zajednica".

"Komitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3, të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës". / "Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo da budu predstavljeni proporcionalno u organima javne službe na lokalnom i centralnom nivou, kao što je naznačeno i Čl. 11, paragraf 3 Zakona Br.03/L-149 o Javnoj Službi Republike Kosova".

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërguesin e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrin brenda 5 ditësh, aplikacionet që arrin pas këtij afati nuk do të shqyrtohen fare / Poštanske pošiljke s poštanskim žigom na pošiljci napravljenim posljednjeg dana roka za prijavu smatrat će se važećim i smatrat će se ako dostignu u roku od 5 dana, a prijave koje stignu nakon ovog uopšte neće biti razmatrano.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen / Dostavljenog roka se ne primaju, isto i nekompletirane aplikacije.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen / Samo izabrani kandidati užeg kruga u spisku treba da se kontaktiraju.

Emri, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që mund të kontaktohet në rast të ndonjë pyetjeje:

Ime, prezime i broj telefona osobe koju treba kontaktirati u slučaju bilo kakvih nedoumica:

Divizioni për Burime Njerëzore/Rukovodioc Odseka za Ljudske Resurse, tel: 038-200-10-804







## KONKURS

### EDUKIDS NË FERIZAJ, SHPALL KONKURS:

- Edukatore - 3 vende të lira;
- Motër Edukatore - 3 vende të lira;
- Kuzhinierë - 1 vend i lirë;
- Pastruese - 1 vend i lirë.

**Për të qenë pjesë e EduKids në Ferizaj, ju duhet t'i plotësoni këto kushte dhe kritere:**

- Edukatore dhe motër edukatore  
Të keni të kryer Fakultetin e Edukimit (Drejtimi Parashkollor, Pedagogji);  
Të keni të kryer Shkollën e mesme të mjekësisë - Drejtimi i Përgjithshëm;  
Drejtimi i Peditrisë; Drejtimi Mamisë ose edhe Fakultetin e Mjekësisë - Drejtimi Infjermeri (vlen vetëm për motër edukatore);  
Përvojë pune;  
Të keni aftësi të shkëlqyera komunikative për të krijuar raporte ndërpersonale me fëmijët;  
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar, energjikë dhe emocionalisht të gatshëm për t'u përballuar me situata emergjente;  
Të njihni mirë psikologjinë dhe botëkuptimin e fëmijeve;  
Të jepni ndihmën e parë në rastet emergjente.

#### • Kuzhinierë

- Të keni të përfunduar shkollimin e mesëm si dhe përvojë pune së paku 2 vite;  
Të keni aftësi të shkëlqyera komunikative për të krijuar raporte ndërpersonale me stafin dhe fëmijët;  
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar dhe energjikë.

#### • Pastruese

- Të keni të përfunduar shkollimin e mesëm si dhe përvojë pune së paku 2 vite;  
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar dhe energjikë.

#### Kandidatet e interesuara duhet të kompletojnë dokumentet:

- CV;
- Diploma dhe çertifikatat e trajnimeve (nëse keni);
- Dëshmitë mbi punët paraprake (nëse keni punuar më herët);
- Çertifikata e lindjes.

Të gjitha këto dokumente duhet të dërgohen në adresën: [edukids05@gmail.com](mailto:edukids05@gmail.com)  
Për info shtesë, kontaktoni EduKids +383 45 714 713 (viber&whatsApp)  
**KONKURSI MBETET I HAPUR DERI MË 31 KORRIK 2019**

Vetëm kandidatet e kualifikuara do të ftohen për intervistë



## KONKURS

- Edukatore** - 3 vende të lira
- Motër Edukatore** - 3 vende të lira
- Kuzhinierë** - 1 vend i lirë
- Pastruese** - 1 vend i lirë

CV-të e kompletuara me dokumentet e kërkuara të dërgohen në: [edukids05@gmail.com](mailto:edukids05@gmail.com) deri në datën **31 Korrik 2019**

Për info shtesë, kontaktoni: **+383 45 714 713**

